

URDHËR
Nr. 114, datë 6.6.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SISTEMET E AVIONËVE PA PILOT
DHE OPERATORËT E SISTEMEVE TË AVIONËVE PA PILOT¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 10489, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, dhe në përputhje me vendimin nr. 1095, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

URDHËROJNË:

1. Miratimin e Rregullore për Sistemet e Avionëve pa Pilot dhe Operatorët e Sistemeve të Avionëve pa Pilot, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Aviacionit Civil, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

RREGULLORE
**PËR SISTEMET E AVIONËVE PA PILOT DHE OPERATORËT E SISTEMEVE TË
AVIONËVE PA PILOT**

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat për projektimin dhe prodhimin e sistemeve të avionëve pa pilot (UAS), të cilët kanë për qëllim të operojnë sipas rregullore mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot (pika 31, neni 3, i kësaj rregulloreje). Ajo, gjithashtu, përcakton llojin e UAS-së, projektimi, prodhimi dhe mirëmbajtja e të cilit do t'i nënshtrohet certifikimit.

2. Kjo rregullore përcakton edhe rregulla për të bërë UAS-të dhe setet e aksesorëve dhe pajisjet shtesë të identifikimit në distancë të disponueshëm në treg dhe për lëvizjen e tyre të lirë në Republikën e Shqipërisë.

3. Kjo rregullore përcakton, gjithashtu, rregulla për operatorët UAS, nëse UAS-ja operohet në Shqipëri.

¹ Ky urdhër përafrohet pjesërisht Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) nr. 2019/945, të datës 12 mars 2019, mbi sistemet e avionëve pa pilot dhe mbi operatorët e vendeve të treta të sistemeve të avionëve pa pilot, e ndryshuar me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2020/1058, të 27 prillit 2020. Numri CELEX 02019R0945 dhe 02020R1058. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 152, datë 11.6.2019 dhe nr. 232, datë 20.7.2020.

Neni 2 Qëllimi

1. Kapitulli II i kësaj rregulloreje zbatohet për produktet e mëposhtme:
 - a) UAS-ja që ka për qëllim të operohet, sipas rregullave dhe kushteve të zbatueshme për kategorinë “e hapur” të operimeve UAS ose deklaratimet operacionale nën kategorinë “specifike”, në përputhje me rregulloren mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot (pika 31, neni 3, i kësaj rregulloreje), përveç UAS-së së ndërtuar privatisht, dhe që mban një etiketë identifikimi të klasës, siç përcaktohet në pjesët 1 deri 5, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje që tregon se cilës nga shtatë klasat e UAS-së i përket;
 - b) klasa C5 e seteve të aksesorëve, siç përcaktohet në pjesën 16;
 - c) elementet shtesë të identifikimit në distancë, siç përcaktohet në pjesën 6 të aneksit të kësaj rregulloreje.
2. Kapitulli III i kësaj rregulloreje zbatohet për UAS të operuar, sipas rregullave dhe kushteve të zbatueshme për kategoritë “të certifikuar” dhe “specifike” të operimeve UAS, në përputhje me rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot, përveçse kur kryhen me deklaram.
3. Kapitulli IV i kësaj rregulloreje vlen për operatorët UAS, që kanë vendin e tyre kryesor të biznesit, janë krijuar ose ndodhen në një vend tjetër, nëse UAS operohet në Shqipëri.
4. Kjo rregullore nuk zbatohet për UAS-të e destinuar të operohen ekskluzivisht në ambiente të mbyllura.

Neni 3 Përkufizime

- Për qëllimet e kësaj rregulloreje, përdoren përkufizimet e mëposhtme:
1. **“Akreditim”** është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.
 2. **“Avion pa pilot”** (UA) (*unmanned aircraft*) është çdo avion që operon ose është krijuar për të operuar në mënyrë autonome ose për t’u pilotuar nga distanca pa një pilot në bord.
 3. **“Bërje e disponueshme në treg”** është çdo furnizim i një produkti për shpërndarje, konsum ose përdorim në tregun shqiptar gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.
 4. **“Gjeondërgjegjësimi”** është një funksion që, bazuar në të dhënat e mundësuar nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, zbulon një shkelje të mundshme të kufizimeve të hapësirës ajrore dhe paralajmëron pilotët në distancë, në mënyrë që ata të mund të ndërmarrin veprime të menjëhershme dhe efektive për të parandaluar atë shkelje.
 5. **“Hapësira ajrore e Qiellit të Vetëm Evropian”** është hapësira ajrore mbi territorin në të cilin zbatohen traktatet, si dhe çdo hapësirë tjetër ajrore ku Palët Kontraktuese, sipas përcaktimit të Marrëveshjes Shumëpalëshe për krijimin e një Zone të Përbashkët Aviacioni Evropian zbatojnë legjislacionin mbi organizimin dhe përdorimin e hapësirës ajrore brenda Qiellit të Vetëm Evropian.
 6. **“Identifikim i drejtpërdrejtë nga distanca”** është një sistem që siguron transmetimin lokal të informacionit, në lidhje me një “UA në operim”, duke përfshirë markën e UA-së, në mënyrë që këto informacione të mund të merren pa qasje fizike në UA.
 7. **“Kategoria ‘e hapur’**”, është një kategori e operimeve UAS që përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3, i këtij neni).
 8. **“Kategori ‘specifike’**”, është një kategori e operimeve UAS, që përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot.
 9. **“Kategori ‘e certifikuar’**” është një kategori e operimit UAS, që përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për operimin e Avionëve pa Pilot.
 10. **“Kthim i produktit”**, është çdo masë që synon të arrijë kthimin e një produkti që është vënë tashmë në dispozicion të përdoruesit përfundimtar.

11. **“Markim CE”** është markimi, me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.
12. **“Marrëveshje shumëpalëshe”** është marrëveshja shumëpalëshe, shtojcat dhe protokollit i saj për krijimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ZPEA), e ratifikuar me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, në vijim referuar si “marrëveshja shumëpalëshe”.
13. **“Modaliteti i ndjekjes”** është një mënyrë funksionimi të një UAS-je kur avioni pa pilot vazhdimisht ndjek pilotin në distancë brenda një rrezeje të paracaktuar.
14. **“Nata”** janë orët ndërmjet fundit të muzgut të mbrëmjes dhe fillimit të muzgut të mëngjesit, siç përcaktohet në rregulloren në fuqi “Për rregullat e ajrit dhe parashikimet operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”.
15. **“Ndalim i tregtimit”** është çdo masë që ka për qëllim, parandalimin në zinxhirin e furnizimit, për bërjen të disponueshme në treg të produktit.
16. **“Ngarkesë”** është çdo instrument, mekanizëm, pajisje, pjesë, aparat, pajisje shtesë ose aksesori, duke përfshirë pajisjen e komunikimit që i është instaluar ose bashkangjitur avionit dhe nuk përdoret ose ka për qëllim të përdoret në operimin ose kontrollimin e avionit në fluturim dhe nuk është pjesë e korpusit/skeletit të avionit, motorit ose helikës.
17. **“Niveli i fuqisë së tingullit LWA”** është fuqia e ponderuar e tingullit në dB, në lidhje me 1 pW, siç përcaktohet në “SSH EN ISO 3744 – Akustika – Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zërit dhe niveleve të energjisë së zërit të burimeve të zhurmës, duke përdorur presionin e zërit – Metodatat inxhinierike për një fushë në thelb të lirë mbi një plan reflektues”, apo përditësimin e tij.
18. **“Niveli i matur i fuqisë së tingullit”** është një nivel i fuqisë së tingullit, siç përcaktohet nga matjet e përcaktuara në pjesën 13 të aneksit; vlerat e matura mund të përcaktohen ose nga një përfaqësues i vetëm i UA-së për llojin e pajisjes, ose nga mesatarja e një numri të UA-së.
19. **“Niveli i garantuar i fuqisë së tingullit”** është një nivel i fuqisë së tingullit të përcaktuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën 13 të aneksit, i cili përfshin paqartësitë për shkak të ndryshimeve të prodhimit dhe procedurave të matjes dhe ku prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i vendosur në Komunitet, konfirmon që sipas instrumenteve teknike të përdorura dhe të përmendura në dokumentacionin teknik, ai nuk tejkalohet.
20. **“Njësi komanduese (CU)”** është pajisja ose sistemi i pajisjeve për të kontrolluar avionët pa pilot nga distanca, siç përcaktohet në pikën 17, të nenit 3, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, që mbështet kontrollin ose monitorimin e avionit pa pilot gjatë çdo faze të fluturimit, me përjashtim të çdo infrastrukture që mbështet shërbimin e lidhjes së komandës dhe kontrollit (C2).
21. **“Operatorë ekonomikë”** është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit, importuesi dhe shpërndarësi i UAS-së.
22. **“Operator i sistemit të avionëve pa pilot”** (operatori UAS) është çdo person juridik ose fizik që operon ose ka ndërmend të operojë një ose më shumë UAS.
23. **“Organ i vlerësimit të konformitetit”** është një organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.
24. **“Pajisje për të kontrolluar avionin pa pilot nga distanca”** është çdo instrument, pajisje, mekanizëm, aparat, pajisje shtesë, program/softuer ose aksesori që është i domosdoshëm për operimin e sigurt të një UA-je, i ndryshëm nga një pjesë dhe që nuk transportohet në bordin e atij UA-je.
25. **“Pesha maksimale e ngritjes (MTOM)”** është pesha maksimale e UA-së, përfshirë ngarkesën dhe karburantin, siç përcaktohet nga prodhuesi ose ndërtuesi, me të cilin UA-ja mund të operohet.
26. **“Përfaqësues i autorizuar”**, është çdo person fizik ose juridik të vendosur brenda ZPEA-së ose Shqipërisë, i cili ka marrë një mandat/autorizim me shkrim nga një prodhues për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyrat e specifikuara.
27. **“Pilot në distancë”** është një person fizik përgjegjës për kryerjen e sigurt të fluturimit të një UA-je, duke operuar kontrollin e tij të fluturimit, qoftë manualisht ose, kur UA-ja fluturon automatikisht, duke monitoruar kursin e tij dhe duke qenë në gjendje të ndërhyjë dhe të ndryshojë kursin e tij në çdo kohë.

28. “**Produkte**” janë të gjitha produktet e përmendura në pikën 1, të nenit 2, të kësaj rregulloreje.
29. “**Prodhues**” është çdo person fizik ose juridik që prodhon një produkt ose ka një produkt të projektuar ose prodhuar, dhe e tregon atë produkt nën emrin ose markën e tyre tregtare.
30. “**Qëndrimi pezull (hovering)**” është qëndrimi në të njëjtin pozicion gjeografik në ajër.
31. “**Rregullore mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot**” është rregullorja e ministrit përgjegjës për transportin ajror, që përaftron Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2019/947.
32. “**Sistemi i avionëve pa pilot (UAS)**” është një avion pa pilot dhe pajisjet për ta kontrolluar atë nga distanca.
33. “**Specifikim teknik**” është një dokument që përshkruan kërkesat teknike që një produkt duhet të përmbushë.
34. “**Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut**”, është:
- **Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut**, për mbikëqyrjen e tregut të produkteve, sipas kësaj rregulloreje, për përdorim nga konsumatorët;
 - **Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial**, për produkteve sipas kësaj rregulloreje, për përdorim jokonsumator.
35. “**Standard i harmonizuar**” është një standard shqiptar, që transponon një standard të harmonizuar evropian, në mbështetje të këtyre rregullave, sipas listës së standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshimi të saj të botuar në Fletoren Zyrtare.
36. “**Shërbimi i lidhjes C2**” është një shërbim komunikimi i ofruar nga një palë e tretë, duke ofruar komandë dhe kontroll midis avionit pa pilot dhe CU-së.
37. “**Shpërndarës**” është çdo person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, i ndryshëm nga prodhuesi ose importuesi, i cili vë në dispozicion një produkt në treg.
38. “**UAS i ndërtuar privatisht**” është një UAS e montuar/ndërtuar ose prodhuar për përdorim të vetë ndërtuesit, duke mos përfshirë UAS të montuara/ndërtuara nga një grup pjesësh të vendosura në treg nga prodhuesi si një pajisjeje të vetme (kit), e gatshme për t'u ndërtuar.
39. “**Vendosje në treg**” është bërja e disponueshme për herë të parë e produktit në treg.
40. “**Vlerësim i konformitetit**” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuara për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose trup.

KAPITULLI II

UAS QË KA PËR QËLLIM PËR T’U OPERUAR NË KATEGORINË “E HAPUR” OSE NË KATEGORINË “SPECIFIKE”, SIPAS DEKLARATËS OPERATIVE, SETEVE TË AKSESORËVE QË KANË NJË ETIKETË TË IDENTIFIKIMIT TË KLASËS DHE ELEMENTET SHITESË TË IDENTIFIKIMIT NË DISTANCË

SEKSIONI 1

KËRKESAT E PRODUKTTIT

Neni 4

Kërkesat

1. Produktet e përmendura në pikën 1, të nenit 2, duhet të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje.
2. UAS që nuk janë lodra brenda kuptimit të VKM-së nr. 262, datë 3.4.2013, “Për miratimin e rregullës teknike “Për sigurinë e lodrave”, do të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse thelbësore të shëndetit dhe sigurisë, të përcaktuara në VKM nr. 1060, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullës teknike “Për makineritë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, vetëm në lidhje me rreziqe të ndryshme nga ato të lidhura me sigurinë e fluturimit të UA-së.
3. Çdo përditësim i programit/softwaret të produkteve që janë vënë tashmë në dispozicion në treg mund të bëhet vetëm nëse këto përditësime nuk ndikojnë në përputhshmërinë e produktit.

Neni 5

Bërja e disponueshme e produktit në treg dhe lëvizja e lirë e produkteve

1. Produktet bëhen të disponueshme në treg vetëm nëse janë prodhuar në përputhje me kërkesat e këtij kapitulli dhe nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e personave, kafshëve ose pronave.

2. Bërja e disponueshme në treg e produkteve që përputhen me kërkesat e këtij Kapitulli, nuk do të ndalohej, kufizohet ose pengohet, për aspektet e përfshira në këtë Kapitull.

SEKSIONI 2

DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 6

Detyrimet e prodhuesve

1. Kur prodhuesi vendos produktin e tij në treg, ai siguron se ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik dhe kryen procedurën përkatëse të vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në këtë rregullore.

Kur përputhshmëria e produktit me kërkesat e përcaktuara në pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje, është demonstruar nga kjo procedurë e vlerësimit të konformitetit, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit dhe fikson markimin CE.

3. Prodhuesi ruan dokumentacionin teknik dhe deklaratën e konformitetit EU, për 10 vjet, pasi produkti të jetë vendosur në treg.

4. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat e nevojshme, që prodhimi në seri i produktit të mbetet në konformitet, në përputhje me sa përshkruhet në këtë kapitull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e produktit, si dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara shqiptare, standardet ndërkombëtare ose në specifikimet teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar konformiteti i një produkti, do të merren parasysh në mënyrë të përshtatshme.

Kur vlerësohet e përshtatshme, në lidhje me rreziqet e paraqitura nga një produkt, prodhuesit, për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, kryejnë testimin e mostrave të produkteve të tregtuara, hetojnë dhe, nëse është e nevojshme, do të mbajnë një regjistër të ankesave, të produkteve të papërputhshme dhe produktet e kthyera dhe do t'i mbajnë të informuar shpërndarësit për çdo monitorim të tillë.

5. Prodhuesit e UAS-së sigurojnë që UA-ja e vendosur në treg prej tyre, të ketë një tip brenda kuptimit të përcaktimeve të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, të ketë të shënuar, serinë ose numrin serial unik ose element tjetër që lejon identifikimin e atij produkti ose, kur madhësia ose natyra e produktit nuk e mundëson atë, informacioni i kërkuar vendoset në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të produktit dhe, nëse është e aplikueshme, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesët përkatëse 2 deri 4, 16 dhe 17 të aneksit. Prodhuesit e seteve të aksesorëve të klasës C5 do të garantojnë që setet kanë një tip dhe numër serial unik, që lejon identifikimin e tyre. Prodhuesit e elementeve shtesë të identifikimit në distancë duhet të sigurojnë që elementi shtesë i identifikimit në distancë të ketë të shënuar tipin dhe një numër serial unik, që lejon identifikimin e tyre dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesën 6 të aneksit të kësaj rregulloreje. Në të gjitha rastet, prodhuesit do të sigurojnë që një numër serial unik t'i bashkohet, gjithashtu, deklaratës EU të konformitetit ose deklaratës EU të thjeshtuar të konformitetit të përcaktuar në pjesën 14, të aneksit të kësaj rregulloreje.

6. Prodhuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare, adresën e faqes së internetit dhe adresën postare, në të cilën ai mund të kontaktohet ose, kur ky

informacion nuk mund të vendoset në produkt, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të tij. Të dhënat për adresën duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

7. Prodhuesi siguron që produkti shoqërohet me manualin dhe dokumentin e njoftimit të informacionit të kërkuar nga pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje, në gjuhët shqipe dhe anglishte, që të mund të kuptohet lehtësisht nga përdoruesit dhe konsumatorët e tjerë. Një manual i tillë dhe dokumenti i njoftimit të informacionit, si dhe çdo etiketim, do të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i lexueshëm.

8. Prodhuesi siguron që produkti të shoqërohet nga një kopje e deklaratës EU të konformitetit, ose nga një deklaratë e thjeshtuar EU e konformitetit. Kur jepet një deklaratë e thjeshtuar EU e konformitetit, ajo duhet të përmbajë adresën e saktë të internetit ku mund të merret teksti i plotë i deklaratës së konformitetit.

9. Prodhuesit që konsiderojnë ose kanë arsye për të besuar se produkti që kanë vendosur në treg nuk është në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë kapitull, duhet që menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë produktin në përputhshmëri ose, sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu, nëse është e përshtatshme. Kur produkti paraqet rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

10. Prodhuesit, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i sigurojnë asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të produktit të përcaktuar për të demonstruar përputhshmërinë e produktit me këtë kapitull, në gjuhën shqipe. Prodhuesit bashkëpunojnë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga produkti që ata kanë vendosur në treg.

11. Kur vendosin në treg një UAS të klasës C5 ose C6 ose një shtesë të klasës C5, prodhuesit duhet të informojnë autoritetin e mbikëqyrjes së tregut të shtetit ku ai ka vendin kryesor të biznesit.

Neni 7

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Prodhuesi, me një akt përfaqësimi, mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 6, dhe detyrimi për të hartuar dokumentacionin teknik, të referuar në pikën 2, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, nuk mund të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit, të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të kryejë, së paku:

a) të mbajë deklaratën EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për 10 vjet nga vendosja e produktit në treg;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në rast të një kërkesë të arsyetuar nga ana e saj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e përputhshmërisë së produktit;

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës së bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve të shfaqura nga produkti, për të cilën i është lëshuar akti i përfaqësimit.

Neni 8

Detyrimet e importuesve

1. Importuesit vendosin në tregun shqiptar vetëm produktet të cilat janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kapitullin II të kësaj rregulloreje dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Para vendosjes së produktit në treg, importuesit sigurohen që:

a) prodhuesi i ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit të përcaktuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje;

b) prodhuesi ka hartuar dokumentacionin teknik;

c) produkti mban markimin CE dhe, kur kërkohet, etiketën e identifikimit të klasës UA dhe tregimin e nivelit të fuqisë së tingullit;

d) produkti shoqërohet me dokumentet e përcaktuara, pikat 7 dhe 8, të nenit 6;

e) prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 6.

Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se një produkt nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje, ai nuk duhet të vendosë produktin në treg, derisa ta sjellë në konformitet. Kur produkti paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Importuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, faqen e internetit dhe adresën postare ku mund të kontaktohet ose, kur ky informacion nuk është i mundur të vendoset në produkt, importuesi i vendos ato në paketimin ose dokumentet shoqëruese të saj. Të dhënat mbi adresën duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Importuesit sigurojnë që produkti shoqërohet me manualin dhe dokumentin e njoftimit të informacionit të përcaktuar në pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17 të aneksit, në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Udhëzuesit dhe informacioni i sigurisë, si dhe çdo etiketim tjetër duhet të jenë të qartë, të lexueshëm dhe lehtësisht të kuptueshëm.

5. Importuesit sigurojnë që gjatë kohës që produkti është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e produktit me kërkesat e përcaktuara në nenin 4.

6. Kur importuesi dyshon se produkti që ai ka bërë të disponueshme në treg mund të paraqesë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve, kryen testimin e mostrave të produkteve të bëra të disponueshme në treg, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për produktet që nuk janë në konformitet dhe produkte të kthyer nga konsumatori ose përdoruesi i fundit, si dhe informon shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

7. Importuesit, të cilët konsiderojnë ose kanë arsye për të besuar se produkti, të cilin ata kanë vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi të harmonizuar të BE-së, duhet menjëherë të marrin masat e nevojshme korrigjuese, për ta sjellë atë produkt në konformitet ose, sipas rastit, të ndalojnë tregtimin apo ta kthejnë atë nga tregu. Kur produkti paraqet rrezik, importuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

8. Importuesit mbajnë deklaratën e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për 10 vjet pas vendosjes së produktit në treg, dhe sigurojnë që dokumentacioni teknik mund t'u vihet në dispozicion strukturave të tilla, sipas kërkesës.

9. Importuesit, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i sigurojnë atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të produktit në gjuhën shqipe. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga produkti i e vendosur në treg prej tij.

10. Kur vendosin në treg një UAS të klasës C5 ose C6 ose një shtesë të klasës C5, importuesit duhet të informojnë autoritetin e mbikëqyrjes së tregut, ku ata kanë vendin kryesor të biznesit.

Neni 9

Detyrimet e shpërndarësve

1. Kur produkti bëhet i disponueshëm në treg, shpërndarësit duhet të veprojnë me kujdesin e duhur, në lidhje me respektimin e kërkesave të përcaktuara në këtë kapitull.

2. Para bërjes së disponueshme në treg të një produkti, shpërndarësi verifikon që produkti mban markimin CE të konformitetit, sipas rastit, dhe, kur është e aplikueshme, etiketën e identifikimit të klasës UA dhe treguesin e nivelit të fuqisë së tingullit, dhe shoqërohet nga dokumentet e referuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 6, si dhe që prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 6 dhe në pikën 3, të nenit 8.

Shpërndarësit sigurojnë që produkti shoqërohet me manualin dhe dokumentin e njoftimit të informacionit të kërkuar nga pjesët 1 deri 6, 16 dhe 17, të aneksit, në shqipe dhe në një gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë. Ky manual dhe dokumenti i njoftimit të informacionit, si dhe çdo etiketim, do të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i lexueshëm.

Kur shpërndarësi konsideron ose ka arsye për të besuar se produkti nuk është në konformitet me kërkesat e përcaktuara në nenin 4, ai nuk duhet të bëjë të disponueshme në treg produktin, derisa ajo të silltet në konformitet me kërkesat ligjore të zbatueshme për të. Kur produkti shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Shpërndarësit sigurojnë që, gjatë kohës kur produkti është nën përgjegjësinë e tyre, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 4.

4. Shpërndarësit, të cilët konsiderojnë ose kanë arsye për të besuar se produkti, të cilën ai e kanë bërë të disponueshme në treg, nuk është në përputhje me këtë rregullore, dhe legjislacionin e harmonizuar në fuqi sigurojnë, marrjen e masave korrigjuese për sjelljen e produktit në konformitet ose, sipas rastit ndalimin e tregtimit ose kthimin e tij. Kur produkti paraqet rrezik, shpërndarësi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

5. Me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, shpërndarësi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar përputhshmërinë e produktit. Shpërndarësi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse, sipas kërkesës së saj, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga produkti i bërë i disponueshme në treg prej tij.

Neni 10

Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesve zbatohen për importuesit dhe shpërndarësit

Një importues ose shpërndarës do të konsiderohet prodhues, për qëllimet e këtij kapitulli, dhe u nënshtrohet detyrimeve të prodhuesit, sipas nenit 6, kur ai vendos një produkt në treg nën emrin ose markën e tij tregtare ose modifikon produktin të vendosur tashmë në treg në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në këtë kapitull.

Neni 11

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës, informojnë autoritetet e mbikëqyrjes së tregut me të dhënat identifikuese, për sa më poshtë:

- a) çdo operator ekonomik, që i ka furnizuar ata me një produkt;
- b) çdo operator ekonomik, të cilin ata e kanë furnizuar me një produkt.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni:

- a) për 10 vjet, pasi janë furnizuar me produktin;
- b) për 10 vjet, pasi kanë furnizuar me produktin.

SEKSIONI 3 PËRPUTHSHMËRIA E PRODUKTTIT

Neni 12

Prezumimi i konformitetit

1. Një produkt që është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, prezumohet se është në përputhje me kërkesat e mbuluara nga ato standarde ose pjesë të tyre të përcaktuara në pjesët 1 deri në 6, 16 dhe 17 të aneksit.

Neni 13

Deklarata EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit, e përmendur në pikën 8, të nenit 6, provon se është demonstruar përmbushja e përputhshmërisë së produktit me kërkesat e përcaktuara në pjesët 1 deri në 6, 16 dhe 17 të aneksit të kësaj rregulloreje dhe, për UAS, identifikon klasën e tij.

2. Deklarata EU e konformitetit hartohet sipas formës së përcaktuar në pjesën 11 të aneksit. Ajo përmban elementet e specifikuar në këtë pjesë dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe dhe në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi dhe nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Deklarata EU e thjeshtuar e konformitetit e përmendur në paragrafin 8 të nenit 6 do të përmbajë elementet e përcaktuara në pjesën 12 të aneksit. Ajo përmban elementet e specifikuar në këtë pjesë dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe dhe në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi i fundit dhe nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Kur produkti është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligjor, që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, për të gjitha këto akte hartohet një deklaratë e vetme EU konformiteti. Deklarata duhet të përmbajë identifikimin e akteve ligjore të zbatueshme, duke përfshirë referencat e tyre të botimit.

5. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 14

Procedurat e vlerësimit të konformitetit, të miratimit të organeve të vlerësimit të konformitetit, të miratimit të organizmave evropianë të notifikuar, kërkesat për miratimin e organeve të miratuara, si dhe mbikëqyrja e tyre bëhen në përputhje me ligjin nr. 10489, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, si dhe me pjesët përkatëse të aneksit të kësaj rregulloreje.

SEKSIONI 4 MBIKËQYRJA E TREGUT DHE KONTROLLI I PRODUKTEVE QË HYJNË NË TREG

Neni 15

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i produkteve që hyjnë në treg

1. Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i produkteve që hyjnë në treg kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, referuar në pikën 34, neni 3 i kësaj rregulloreje, sipas

parashikimeve dhe në përputhje me ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, dhe të VKM-së nr. 1060, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik për makineritë dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”.

2. Autoriteti i Aviacionit Civil, si autoriteti kompetent për sigurinë në operim, sipas përcaktimeve në nenin 8, të ligji 96/2020, do të sigurohet që të bashkëpunojë me autoritetet e mbikëqyrjes së tregut dhe kontrollit kufitar për çështjet e sigurisë dhe vendosjen e mekanizmave të duhur të komunikimit dhe të koordinimit, duke shfrytëzuar sa më mirë informacionin e përfshirë në sistemin e raportimit të ngjarjeve të përcaktuara në ligjin nr. 96/2020 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, dhe sistemeve të informacionit të përcaktuara në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar.

Neni 16

Procedura për trajtimin e produkteve që paraqesin rrezik në nivelin kombëtar

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, referuar në pikën 34, neni 3, i kësaj rregulloreje, ka arsye të mjaftueshme për të besuar se një produkt paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave ose për aspektet e tjera të mbrojtjes së interesit publik të përfshira në këtë kapitull, ato duhet të kryejnë një vlerësim në lidhje me produktin në fjalë, në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë kapitull. Për këtë qëllim, operatorët përkatës ekonomikë duhet të bashkëpunojnë, sipas nevojës, me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Kur, gjatë vlerësimit të kryer, sipas paragrafit të parë, të kësaj pike, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se produkti nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë kapitull, kërkon pa vonesë nga operatori përkatës ekonomik, që të marrë të gjitha veprimet e duhura korigjuese, për të sjellë produktin në përputhje me këto kërkesa, të ndalojë tregtimin e produktit ose të kthejë produktin nga përdoruesi i fundit brenda një periudhe të arsyeshme, në përputhje me natyrën e rrezikut që paraqitet.

2. Veprimet korigjuese të përmendura në paragrafin e dytë të pikës 1 të këtij neni, merren në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

3. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura korigjuese, në lidhje me produktin në fjalë, që ai ka bërë të disponueshme në treg.

4. Kur operatori përkatës ekonomik nuk merr masat e duhura korigjuese brenda periudhës së referuar në paragrafin 2, të pikës 1, të këtij neni, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut merr të gjitha masat e përkohshme të përshtatshme për të ndaluar ose për të kufizuar bërjen të disponueshme në treg të produktit apo për ndalimin e tregimit ose për kthimin e produktit nga përdoruesi i fundit.

5. Informacioni i përmendur në paragrafin 4 përfshin të gjitha detajet në dispozicion, veçanërisht të dhënat e nevojshme për identifikimin e produktit që nuk është në përputhje, origjinën e produktit, natyrën e mospërputhshmërisë së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të marra dhe argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik përkatës. Në veçanti, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut tregojnë nëse mospërputhja është për shkak të njëres nga sa vijon:

- a) pamundësisë së produktit për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në nenin 4;
- b) mangësive në standardet e harmonizuara të përmendura në nenin 12.

Neni 17

Produkt në përputhje por që paraqet një rrezik

1. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, referuar në pikën 34, neni 3 i kësaj rregulloreje, pas vlerësimit të bërë sipas pikës 1, të nenit 15, të kësaj rregulloreje, konstaton se edhe pse produkti është në përputhje me këtë kapitull, ai paraqet rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave ose për aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik, mbrojtje e mbuluar nga ky kapitull, ai do t'i kërkojë operatorit përkatës ekonomik që të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar që produkti në fjalë, i vendosur në treg, të mos paraqesë rrezik, të ndalojë tregtimin e produktit ose të kthejë produktin brenda një periudhe të arsyeshme, në përpjesëtim me natyrën e rrezikut që paraqitet.

2. Operatori ekonomik duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime korrigjuese, në lidhje me të gjitha produktet që ai ka bërë të disponueshme në treg.

Neni 18

Mospërputhshmëria formale

1. Pa paragjykuar parashikimet e nenit 16, të kësaj rregulloreje, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, referuar në pikën 34, neni 3, i kësaj rregulloreje, në përputhje me dispozitat përkatëse në VKM-në nr. 1060, datë 23.12.2015, në fuqi për këto produkte, i kërkon operatorit përkatës ekonomik t'i japë fund mospërputhjes në fjalë, kur konstaton një nga rastet e mëposhtme:

a) markimi CE është fiksuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore;

b) markimi CE nuk është fiksuar;

c) numri i identifikimit të organit të miratuar, kur zbatohet procedura e vlerësimit të konformitetit, pasi nuk është vendosur;

d) etiketa e identifikimit të klasës UA nuk është vendosur;

e) tregimi i nivelit të fuqisë së tingullit, nëse kërkohet, nuk është vendosur;

f) numri serial nuk është vendosur ose nuk ka formatin e saktë;

g) manuali ose njoftimi i informacionit nuk është i disponueshëm;

h) deklarata e EU e konformitetit mungon ose nuk është hartuar;

i) deklarata e EU e konformitetit nuk është hartuar në mënyrë korrekte;

j) dokumentacioni teknik nuk është i disponueshëm ose jo i plotë;

k) emri i prodhuesit ose i importuesit, emri tregtar i regjistruar ose marka tregtare e regjistruar, adresa e internetit ose adresa postare mungojnë.

2. Kur mospërputhja formale vazhdon, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose për të ndaluar produktet që janë bërë të disponueshme në treg ose për të siguruar që ato të rivlerësohen ose të ndalohet tregtimi ose të kthehen ose të tërhiqet nga tregu.

KAPITULLI III

KËRKESAT PËR UAS TË OPERUAR NË KATEGORITË “TË CERTIFIKUARA” DHE “SPECIFIKE”, PËRVEÇSE KUR OPEROHEN ME DEKLARIM

Neni 19

Kërkesat për UAS e operuara në kategoritë “të certifikuara” dhe “specifike”, përveçse kur operohen me deklaram.

1. Projektimi, prodhimi dhe mirëmbajtja e UAS-së do të certifikohet nga Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar (AAC), nëse UAS-ja përmbush një nga kushtet e mëposhtme:

a) ai ka një dimension karakteristik prej 3 m ose më shumë, dhe është projektuar për të operuar mbi grumbullime të njerëzve;

b) është projektuar për transportimin e njerëzve;

c) është projektuar për qëllime të transportimit të mallrave të rrezikshme dhe kërkon një nivel të lartë të qëndrueshmërisë për të zbutur rreziqet për palët e treta në rast aksidenti;

d) përdoret në kategorinë “specifike” të operimeve të përcaktuara, sipas Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3, e kësaj rregulloreje) dhe kur autorizimi operacional i lëshuar nga AAC-ja, pas një vlerësimi të rrezikut të parashikuar në atë rregullore, konsideron që rreziku i operacionit nuk mund të zbutet në mënyrë të përshtatshme pa certifikimin e UAS-së.

2. Një UAS, që i nënshtrohet certifikimit, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në rregulloret në fuqi të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin ajror, “Për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor të mjeteve fluturuese dhe të produkteve që kanë lidhje me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për certifikimin e organizatave të projektimit dhe prodhimit”, “Mbi specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një tip të caktuar operimesh” dhe “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionit dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”.

3. Përveç rasteve kur duhet të certifikohet në përputhje me pikën 1 të këtij neni, një UAS i përdorur në kategorinë “specifike” duhet të përmbajë aftësitë teknike të përcaktuara në autorizimin operacional të lëshuar nga AAC-ja ose siç përcaktohet nga Certifikata e Operatorit të UAS-së së Lehtë (LUC), në përputhje me pjesën C të shtojcës së Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3, e kësaj rregulloreje).

4. Përveç rasteve kur janë ndërtuar privatisht, të gjitha UAS-të, që nuk i nënshtrohen regjistrimit, sipas përcaktimeve përkatëse të Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot, do të kenë një numër serie unik në përputhje me standardin ANSI/CTA-2063-A-2019, numrat serialë të sistemeve të vogla ajrore pa pilot, 2019, ose rishikimin e tij.

5. Çdo UA, që synohet të operohet në kategorinë “specifike” dhe në një lartësi nën 120 metra, duhet të pajiset me një sistem identifikimi në distancë që lejon:

a) ngarkimi i numrit të regjistrimit të operatorit UAS i kërkuar në përputhje me përcaktimet përkatëse në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot, dhe çdo numër shtesë të ofruar nga sistemi i regjistrimit. Sistemi do të kryejë një kontroll konsistence duke verifikuar integritetin e vargut të plotë të dhënë operatorit UAS në momentin e regjistrimit. Në rast mospërputhjeje, UAS-ja do të lëshojë një mesazh gabimi tek operatori i UAS-së;

b) transmetimin periodik të paktën të të dhënave të mëposhtme, në kohë reale, gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, në një mënyrë që të mund të merret nga pajisjet celulare ekzistuese:

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit të dhënë nga shteti anëtar gjatë procesit të regjistrimit, përveç rasteve kur kontrolli i konsistencës i përcaktuar në pikën “a” nuk kalohet;

ii. numrin serial unik të UA-së në përputhje me paragrafin 4 ose, nëse UA-ja është ndërtuar privatisht, numrin serial unik të shtesës, siç specifkohet në pjesën 6 të shtojcës;

iii. vulën kohore, pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e saj mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv. kursi i itinerarit të matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësia tokësore e UA-së;

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë;

vi. një tregues i statusit të emergjencës të UAS-së.

c) për të reduktuar aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në distancë.

KAPITULLI IV OPERATORËT UAS TË VENDEVE TË TJERA

Neni 20

Operatorët UAS të vendeve të tjera

1. Operatorët UAS, që kanë vendin e tyre kryesor të biznesit, janë themeluar ose banojnë në një vend tjetër, duhet të jenë në përputhje me përcaktimet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3), për qëllimet e operimeve UAS brenda hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti kompetent për operatorin UAS të vendit tjetër do të jetë AAC, si autoriteti kompetent i shtetit ku operatori synon të operojë, kur operimi synohet të kryhet në Shqipëri.

3. Me përjashtim të pikës 1, një certifikatë e aftësisë së pilotit në distancë ose e operatorit UAS, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot, ose një dokument ekuivalent, mund të njihet nga autoriteti kompetent për qëllimin e operimit brenda, për, dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, me kusht që:

- a) vendi tjetër ka kërkuar një njohje të tillë;
- b) certifikata e aftësisë së pilotit në distancë ose certifikata e operatorit UAS janë dokumente të vlefshme të Shtetit të lëshimit; dhe
- c) AAC është siguruar që kërkesat mbi bazën e të cilave janë lëshuar këto certifikata ofrojnë të njëjtin nivel sigurie si kjo rregullore.

KAPITULLI V

Neni 21

Kundërvajtjet administrative


Shkeljet e kërkesave të kësaj rregulloreje nga operatorët ekonomikë trajtohen sipas legjisllacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

ANEKSI

PJESA 1

Kërkesat për një sistem avioni pa pilot i klasit C0

Një UAS e klasit C0 ka në mënyrë të dukshme etiketën e identifikimit klasor në UA, si vijon:



Një UAS e klasit C0 do të jetë në përputhje me:

- 1) të ketë një MTOM më të vogël se 250 g, për
- 2) të ketë një shpejtësi maksimale të fluturimit r
- 3) të ketë një lartësi maksimale të arritshme mbi
- 4) të jetë i kontrollueshëm në mënyrë të sigurt për operimin dhe performancën e lidhjes së të dhënave, nga një UA për udhëzimet e prodhuesit, sipas nevojës në të gjitha kushtet e parafshirë dështimin ose mosfunksionimin e njerit ose, nëse është e përshtatshme, të më shumë sistemeve;

5) të projektohet dhe të ndërtohet në atë mënyrë që të minimizohet dëmtimi i njerëzve gjatë operimit, skajet e mprehta duhet të shmangen, përveç nëse teknikisht janë të pashmangshme, sipas praktikave të mira të projektimit dhe të prodhimit. Nëse është i pajisur me helikë, ai duhet të jetë i projektuar në atë mënyrë, që të kufizojë çdo dëmtim që mund të shkaktohet nga tehet e helikës;

6) të furnizohet ekskluzivisht nga energjia elektrike;

7) nëse është i pajisur me një funksionalitet/modalitet "Follow-me"/ndjekjeje dhe kur ky funksion është i ndezur, të jetë në një interval që nuk tejkalon 50 m nga piloti në distancë dhe të bëjë të mundur që piloti në distancë të rimarrë kontrollin e UA-së;


8) të hidhet në treg me manualin e një përdoruesi, i cili siguron:

- a) karakteristikat e UA-së përfshirë, por jo të kufizuara, në:
 - klasën e UA-së;

- peshën UA (me një përshkrim të konfigurimit të referencës) dhe peshën maksimale të ngritjes (MTOM);
 - karakteristikat e përgjithshme të ngarkesave të lejuara për sa u përket dimensioneve të peshës, ndërfaqeve me UA dhe kufizimeve të tjera të mundshme;
 - pajisjet dhe programet softuer për të kontrolluar UA-në nga distanca;
 - dhe një përshkrim të sjelljes së UA-së, në rast të humbjes së lidhjes së komandë-kontrollit;
 - b) udhëzime të qarta operative;
 - c) kufizimet operationale (përfshirë, por jo të kufizuara në kushtet meteorologjike dhe operimet ditore/të natës); dhe
 - d) përshkrimin e duhur të gjitha rreziqeve që lidhen me operimet UAS të përshtatura për moshën e përdoruesit;
- 9) të përfshijë një njoftim informacioni të publikuar nga Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (EASA) apo AAC, sipas rastit që parashikon kufizime dhe detyrime të zbatueshme, në përputhje me Rregullore mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3, e kësaj rregulloreje);
- 10) pikat 4, 5 dhe 6 nuk zbatohen për UAS që janë lodra në kuptimin e direktivës për sigurinë e lodrave.

PJESA 2 KËRKESAT PËR NJË SISTEM AVIONI PA PILOT I KLASIT C1

Një UAS e klasit C1 ka në mënyrë të dukshme etiketën e identifikimit klasor në UA, si vijon:



- Një UAS e klasit C1 do të jetë në përputhje, me:
- 1) të jetë bërë nga materiale dhe të ketë performanca mekanike të tilla, që të sigurojnë që, në rast të përplasjes me shpejtësi të larta, energjia e transmetuar në kokën e njeriut është më e vogël se ajo e transmetuar në kokën e një MTOM më pak se 900 g, përfshirë ngarkesën;
 - 2) të ketë një shpejtësi maksimale të fluturimit rreth 120 m/s;
 - 3) të ketë një lartësi maksimale të arritshme mbi pikën e ngritjes të kufizuar në 120 m ose të jetë i pajisur me një sistem që kufizon lartësinë mbi sipërfaqe ose mbi pikën e ngritjes në 120 m ose në një vlerë të zgjedhshme nga piloti në distancë. Nëse vlera është e zgjedhshme, informacioni i qartë për lartësinë e UA-së mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes gjatë fluturimit do t'i jepet pilotit në distancë;
 - 4) të jetë i kontrollueshëm në mënyrë të sigurt, në lidhje me stabilitetin, manovrimin dhe lidhjen e komandë-kontrollit, nga një pilot i largët me kompetencën e duhur, sipas rregullores “Mbi rregullat dhe procedurat e operimit të avionëve pa pilot” dhe duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit, sipas nevojës në të gjitha kushtet e parashikuara të operimit, duke përfshirë dështimin/mosfunksionimin e njërës ose, nëse është e përshtatshme, të më shumë sistemeve;
 - 5) të ketë forcën e duhur mekanike, duke përfshirë çdo faktor të nevojshëm të sigurisë dhe, kur është e përshtatshme, stabilitet për t'i bërë ballë çdo sforcimi të cilit i nënshtrohet gjatë përdorimit pa ndonjë thyerje ose deformim që mund të ndërhyjë në fluturimin e tij të sigurt;
 - 6) të projektohet dhe të ndërtohet në mënyrë të tillë, që të minimizojë dëmtimin e njerëzve gjatë operimit, skajet e mprehta duhet të shmangen, përveç nëse teknikisht janë të pashmangshme, në bazë të praktikës së mirë të projektimit dhe të prodhimit. Nëse është i pajisur me helikë, ai duhet të jetë i projektuar në atë mënyrë, që të kufizojë çdo dëmtim që mund të shkaktohet nga tehet e helikës;
 - 7) në rast të humbjes së lidhjes së komandë-kontrollit, të ketë një metodë të besueshme dhe të parashikueshme që UA-ja të rikuperojë lidhjen e komandë-kontrollit ose nëse kjo dështon, të përfundojë fluturimin, në një mënyrë që zvogëlon efektin te palët e treta në ajër ose në tokë;

8) me përjashtim të rasteve kur është një UA me krah të fiksuar, të ketë një L_{WA} me fuqi A të tingullit të garantuar me ponderim të përcaktuar, sipas pjesës 13, që nuk i tejkalon nivelet e përcaktuara në pjesën 15;

9) me përjashtim të rasteve, kur është një UA me krah të fiksuar, të ketë treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë A së tingullit me ponderim të vendosur në UA dhe/ose në paketimin e tij, siç përcaktohet në pjesën 14;

10) të furnizohet ekskluzivisht nga energjia elektrike;

11) të ketë një numër serial unik fizik që përputhet me *Numrat Serialë të Sistemeve Ajrore të Vogla pa Pilot* të standardit ANSI/CTA-2063-A-2019, *Small Unmanned Aerial Systems Serial Numbers*, 2019;

12) të ketë një identifikim direkt në distancë, që:

a) lejon ngarkimin e numrit të regjistrimit të operatorit UAS, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat e Operimit të Avionëve pa pilot (pika 31, neni 3) dhe çdo numër shtesë të ofruar nga sistemi i regjistrimit; sistemi do të bëjë kontrole të vazhdueshme duke verifikuar integritetin e të gjithë zinxhirit dhënë operatorit të UAS-së në kohën e regjistrimit; në rast të papajtueshmërisë, UAS-ja do të japë për operatorin një mesazh gabimi "error message";

b) siguron, në kohë reale gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, transmetimin direkt periodik nga UA-ja, duke përdorur një protokoll transmetimi të hapur dhe të dokumentuar, të të dhënave vijuese, në një mënyrë që ato të mund të merren direkt nga pajisjet ekzistuese të lëvizshme brenda një diapazoni të transmetimit:

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit dhënë nga shteti i regjistrimit gjatë procesit të regjistrimit, përveç se kur kontrolli i pajtueshmërisë sipas germës (a) të kësaj pike nuk është kaluar me sukses;

ii. numrin unik fizik serial të UA-së në përputhje me pikën 11;

iii. vulën e kohës (*time-stamp*), pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv. kursin e rrugës së matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësia tokësore e UA-së; dhe

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë ose nëse nuk është i disponueshëm, të pikës së ngritjes;

c) ul aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në largësi;

13) të pajiset me një sistem gjeondërgjegjësimi, që siguron:

a) një ndërfaqe për të ngarkuar dhe për të përditësuar të dhëna që përmbajnë informacione mbi kufizimet e hapësirës ajrore të lidhura me pozicionin e UA-së dhe lartësinë e imponuar nga zonat gjeografike, siç përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat e Operimit të Avionëve pa pilot, e cila siguron që procesi i ngarkimit ose përditësimi i këtyre të dhënave nuk degradon integritetin dhe vlefshmërinë e tij;

b) një alarm paralajmërues për pilotin në distancë, kur konstatohet një shkelje e mundshme e kufizimeve të hapësirës ajrore; dhe

c) informacion për pilotin në distancë, mbi statusin e UA-së, si dhe një alarm paralajmërimi, kur sistemet e pozicionimit ose të lundrimit nuk mund të sigurojnë funksionimin e duhur të sistemit të gjeondërgjegjëses;

14) nëse UA-ja ka një funksion që kufizon hyrjen e tij në zona të caktuara të hapësirës apo vëllimeve ajrore, ky funksion duhet të operojë në atë mënyrë që të ndërveprojë pa probleme me sistemin e kontrollit të fluturimit të UA-së, pa ndikuar negativisht në sigurinë e fluturimit; përveç kësaj, informacioni i qartë do t'i jepet pilotit në distancë, kur ky funksion parandalon UA-në të hyjë në këto zona ose pjesë të hapësirës ajrore;

15) t'i sigurojë pilotit në distancë një paralajmërim të qartë, kur bateria e UA-së ose stacioni i saj i kontrollit arrin një nivel të ulët, në mënyrë që piloti në distancë të ketë kohën e mjaftueshme për të ulur në mënyrë të sigurt UA-në;

16) të pajiset:

a) me drita me qëllim të kontrollueshmërisë së UA-së; dhe

b) të paktën një dritë jeshile pulsuese, me qëllim të dallimit/dukshmërisë së UA-së gjatë natës, që t'i mundësojë një personi në tokë, të dallojë UA-në nga një avion i drejtuar me pilot;

17) nëse është i pajisur me një funksionalitet/modalitet "Follow-me"/ndjekjeje dhe kur ky funksion është i ndezur, të jetë në një interval që nuk tejkalon 50 m nga piloti në distancë, dhe të bëjë të mundur që piloti në distancë të rimarrë kontrollin e UA-së;

18) të hidhet në treg me manualin e një përdoruesi, i cili siguron:

a) karakteristikat e UA përfshirë, por jo vetëm të kufizuara, në:

- klasën e UA;

- peshën e UA (me një përshkrim të konfigurimit të referencës) dhe peshën maksimale të ngritjes (MTOM);

- karakteristikat e përgjithshme të ngarkesave të lejuara për sa u përket dimensioneve të peshës, ndërfaqet e UA-së dhe kufizimet e tjera të mundshme;

- pajisjet dhe programet softuer për të kontrolluar UA-në nga distanca;

- referencën e protokollit të transmetimit të përdorur për emetimin direkt të identifikimit në distancë;

- nivelin e fuqisë së tingullit;

- dhe një përshkrim të sjelljes së UA-së, në rast të humbjes së lidhjes së të dhënave; dhe metodën për fitimin e lidhjes së komandë-kontrollit të UA-së;

b) udhëzime të qarta operative;

c) procedurën për të ngarkuar kufizimet e hapësirës ajrore në funksionin e gjeondërgjegjësimit;

d) udhëzimet e mirëmbajtjes;

e) procedurat e zgjidhjes së problemeve;

f) kufizimet operacionale (përfshirë, por jo të kufizuara në kushtet meteorologjike dhe operimet ditore/të natës); dhe

g) përshkrimin e duhur të të gjitha rreziqeve që lidhen me operimet UAS;

19) të përfshijë një njoftim informacioni të publikuar përkatësisht nga EASA dhe/ose AAC-ja, sipas EASA-s, që parashikon kufizime dhe detyrime në fuqi sipas Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3, e kësaj rregulloreje).

20) nëse është i pajisur me një sistem rrjeti të identifikimit në distancë, do të:

a) lejojë, në kohë reale gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, transmetimin direkt periodik nga UA-ja, duke përdorur një protokoll transmetimi të hapur dhe të dokumentuar, të të dhënave vijuese, në një mënyrë që ato të mund të merren nëpërmjet një rrjeti:

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit dhënë nga shteti i regjistrimit gjatë procesit të regjistrimit, përveçse kur kontrolli i pajtueshmërisë, sipas germës "a", të pikës 12, nuk është kaluar me sukses;

ii numrin unik fizik serial të UA-së në përputhje me pikën 11;

iii vulën e kohës (*time-stamp*), pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv kursin e rrugës së matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësia tokësore e UA-së; dhe

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë ose nëse nuk është i disponueshëm, të pikës së ngritjes;


vi. një orientim për statusin e emergjencës së UAS-së;

a) ulë aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në largësi.

PJESA 3

KËRKESAT PËR NJË SISTEM AVIONI PA PILOT I KLASIT C2

Një UAS e klasit C2 ka në mënyrë të dukshme etiketën e identifikimit klasor në UA, si vijon:



Një UAS e klasit C2 do të jetë në përputhje, me sa vijon:

- 1) të ketë një MTOM më të vogël se 4 kg, përfshirë ngarkesën;
- 2) të ketë një lartësi maksimale të arritshme mbi pikën e ngritjes të kufizuar në 120 m ose të jetë i pajisur me një sistem që kufizon lartësinë mbi sipërfaqe ose mbi pikën e ngritjes në 120 m ose në një vlerë të zgjedhshme nga piloti në distancë. Nëse vlera është e zgjedhshme, informacioni i qartë për lartësinë e UA-së mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes gjatë fluturimit do t'i jepet pilotit në distancë;
- 3) të jetë i kontrollueshëm në mënyrë të sigurt për sa u përket stabilitetit, manovrimit dhe performancës së lidhjes së të dhënave, nga një pilot në distancë me kompetencë të përshtatshme, siç përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot (pika 31, neni 3, i kësaj rregulloreje) dhe duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit, sipas nevojës në të gjitha kushtet e parashikuara të operimit përfshirë këtu dështimin/mosfunksionimin e njërit ose, nëse është e përshtatshme, të më shumë sistemeve;
- 4) të ketë forcën e nevojshme mekanike duke përfshirë çdo faktor të nevojshëm të sigurisë dhe, kur është e përshtatshme, stabilitet për t'i bërë ballë çdo sforcimi të cilit i nënshtrohet gjatë përdorimit pa ndonjë thyerje ose deformim që mund të ndërhyjë në fluturimin e tij të sigurt;
- 5) në rastin e një UA-je të lidhur, të ketë një gjatësi tërheqëse të lidhëses që është më e vogël se 50 m dhe një forcë mekanike që është jo më pak, se:
 - a) për avionët më të rëndë se ajri, 10 herë pesha e aerodinës në peshën maksimale;
 - b) për avionët më të lehtë se ajri, 4 herë forca e ushtruar nga kombinimi i shtytjes maksimale statike dhe forcës aerodinamike të shpejtësisë maksimale të lejuar të erës gjatë fluturimit;
- 6) të projektohet dhe ndërtohet në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimin e njerëzve gjatë operimit, skajet e mprehta duhet të shmangen, përveç nëse teknikisht janë të pashmangshme në bazë të praktikës së mirë të projektimit dhe të prodhimit. Nëse është i pajisur me helikë, ai duhet të jetë i projektuar në atë mënyrë që të kufizojë çdo dëmtim që mund të shkaktohet nga tehet e helikës;
- 7) me përjashtim kur është i lidhur, në rast të humbjes së lidhjes së të dhënave, të ketë një metodë të besueshme dhe të parashikueshme që UA-ja të rikuperojë lidhjen e të dhënave ose të përfundojë fluturimin në një mënyrë që zvogëlon efektin te palët e treta në ajër ose në tokë;
- 8) me përjashtim të rasteve kur është i lidhur, të pajiset me një ndërlidhje të dhënash të mbrojtura nga hyrja e paautorizuar në funksionet e kontrollit dhe komandës;
- 9) me përjashtim të rasteve kur është një UA me krah të fiksuar, të jetë i pajisur me një modalitet/funksion me shpejtësi të ulët të zgjedhshme nga piloti në distancë dhe që kufizon shpejtësinë maksimale të fluturimit në jo më shumë se 3 m/s;
- 10) përveç nëse është një UA me krah të fiksuar, të ketë një L_{EA} me nivel fuqie A të tingullit të garantuar me ponderim të përcaktuar, sipas pjesës 10, që nuk i tejkalon nivelet e përcaktuara në pjesën 15;
- 11) përveç nëse është një UA me krah të fiksuar, keni treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit me ponderim A të vendosur në UA dhe/ose paketimin e tij, sipas pjesës 11;
- 12) të furnizohet ekskluzivisht nga energjia elektrike;
- 13) të ketë një numër serial unik fizik në përputhje me *Numrat Serialë të Sistemeve Ajrore të Vogla pa Pilot të standardit ANSI/CTA-2063-A-2019 (Small Unmanned Aerial Systems Serial Numbers, 2019)*;
- 14) të ketë një identifikim të drejtpërdrejtë në distancë, që:
 - a) lejon ngarkimin e numrit të regjistrimit të operatorit UAS, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat e Operimit të Avionëve pa Pilot, dhe çdo numër shtesë dhënë nga sistemi i regjistrimit; sistemi do të bëjë kontrole të vazhdueshme duke verifikuar integritetin e të gjithë zinxhirit dhënë operatorit të UAS në kohën e regjistrimit; në rast të papajtueshmërisë, UAS do të japë për operatorin një mesazh gabimi "error message";
 - b) siguron, në kohë reale gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, transmetimin direkt periodik nga UA-ja, duke përdorur një protokoll transmetimi të hapur dhe të dokumentuar, të të dhënave vijuese, në një mënyrë që ato të mund të merren direkt nga pajisjet ekzistuese të lëvizshme brenda diapazonit të transmetimit;

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit dhënë nga shteti i regjistrimit gjatë procesit të regjistrimit, përveç se kur kontrolli i pajtueshmërisë sipas germës “a” të kësaj pike nuk është kaluar me sukses;

ii. numrin unik fizik serial të UA-së, në përputhje me pikën 13;

iii. pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv. kursin e rrugës së matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësinë tokësore të UA-së; dhe

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë; ose nëse nuk është e mundur pikën e ngritjes;

c) ulë aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në largësi.

15) të pajiset me një funksion të gjeondërgjegjësimi, që siguron:

a) një ndërfaqe për të ngarkuar dhe përditësuar të dhëna që përmbajnë informacione mbi kufizimet e hapësirës ajrore të lidhura me pozicionin e UA-së dhe lartësinë e imponuar nga zonat gjeografike, siç përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot, e cila siguron që procesi i ngarkimit ose përditësimi i këtyre të dhënave nuk e degradon integritetin dhe vlefshmërinë e tij;

b) një alarm paralajmërues për pilotin në distancë, kur konstatohet një shkelje e mundshme e kufizimeve të hapësirës ajrore; dhe

c) informacion për pilotin në distancë mbi statusin e UA-së, si dhe një alarm paralajmërues, kur pozicionimi ose lundrimi i tij nuk mund të sigurojë funksionimin e duhur të sistemit të gjeondërgjegjësimi;

16) nëse UA ka një funksion që kufizon hyrjen e tij në zona të caktuara të hapësirës apo të vëllimeve ajrore, ky funksion duhet të operojë në atë mënyrë që të bashkëveprojë pa probleme me sistemin e kontrollit të fluturimit të UA-së, pa ndikuar negativisht në sigurinë e fluturimit; përveç kësaj, informacioni i qartë do t'i sigurohet pilotit të largët, kur ky funksion parandalon UA-në të hyjë në këto zona ose vëllime të hapësirës ajrore;

17) t'i sigurojë pilotit në distancë një paralajmërim të qartë kur bateria e UA-së ose stacioni i saj i kontrollit arrin një nivel të ulët të tillë, që piloti në distancë të ketë kohën e mjaftueshme për të ulur në mënyrë të sigurt UA;

18) të pajiset:

a) me drita me qëllim të kontrollueshmërisë së UA-së; dhe

b) të paktën një dritë jeshile pulsuese, me qëllim të dallimit/dukshmërisë së UA-së gjatë natës, që t'i mundësojë një personi në tokë, të dallojë UA-në nga një avion i drejtuar me pilot;

19) të hidhet në treg me manualin e një përdoruesi, i cili siguron:

a) karakteristikat e UA-së përfshirë, por jo vetëm të kufizuara, në:

- klasën e UA-së;

- peshën e UA-së (me një përshkrim të konfigurimit të referencës) dhe peshën maksimale të ngritjes (MTOM);

- karakteristikat e përgjithshme të ngarkesave të lejuara, për sa u përket dimensioneve të peshës, ndërfaqeve me UA-në dhe kufizimeve të tjera të mundshme;

- pajisjet dhe programet softuer për të kontrolluar UA-në nga distanca;

- referencën e protokollit të transmetimit të përdorur për emetimin direkt të identifikimit në distancë;

- nivelin e fuqisë së tingullit;

- dhe një përshkrim të sjelljes së UA-së, në rast të humbjes së lidhjes së komandës dhe të kontrollit dhe metodën për ta rifituar lidhjen;

b) udhëzime të qarta operative;

c) procedurën për të ngarkuar kufizimet e hapësirës ajrore në funksionin e gjeondërgjegjësimi;

d) udhëzimet e mirëmbajtjes;

e) procedurat e zgjidhjes së problemeve;


f) kufizimet operacionale (përfshirë, por jo të kufizuara në kushtet meteorologjike dhe operimet ditore/të natës); dhe

g) përshkrimin e duhur të të gjitha rreziqeve që lidhen me operimet UAS;

20) të përfshijë një njoftim informacioni të publikuar nga Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (EASA) apo AAC-së, sipas rastit, që parashikon kufizime dhe detyrime të zbatueshme, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot.

PJESA 4 KËRKESAT PËR NJË SISTEM AVIONI PA PILOT I KLASIT C3

Një UAS e klasit C3 ka në mënyrë të dukshme etiketën e identifikimit klasor në UA, si vijon:



- Një UAS e klasit C3 do të jetë në përputhje, me
- 1) të ketë një MTOM më të vogël se 25 kg, p një dimension
maksimal karakteristik më të vogël se 3 m;
 - 2) të ketë një lartësi maksimale të arritshme m në 120 m ose të
jetë i pajisur me një sistem që kufizon lartësinë m gritjes në 120 m
ose në një vlerë të zgjedhshme nga piloti në e zgjedhshme,
informacioni i qartë për lartësinë e UA-së mbi sip të fluturimit do
t'i jepet pilotit në distancë;
 - 3) të jetë i kontrollueshëm në mënyrë të sigurt, në lidhje me stabilitetin, manovrimin dhe performancën e lidhjes së të dhënave, nga një pilot me kompetencë të përshtatshme, siç përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat e Operimit të Avionëve pa Pilot, dhe duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit, sipas nevojës në të gjitha kushtet e parashikuara të operimit, përfshirë dështimin/mosfunksionimin e njërit ose, nëse është e përshtatshme, të më shumë sistemeve;
 - 4) në rastin e një UA-je të lidhur, të ketë një gjatësi tërheqëse të lidhëses që është më e vogël se 50 m dhe një forcë mekanike, jo më pak se:
 - a) për avionët më të rëndë se ajri, 10 herë, pesha e aerodinës në peshën maksimale;
 - b) për avionët më të lehtë se ajri, 4 herë, forca e ushtruar nga kombinimi i shtytjes maksimale statike dhe forcës aerodinamike të shpejtësisë maksimale të lejuar të erës gjatë fluturimit;
 - 5) me përjashtim të rasteve kur është i lidhur, në rast të humbjes së lidhjes së të dhënave, të ketë një metodë të besueshme dhe të parashikueshme, që UA të rikuperojë lidhjen e të dhënave ose të përfundojë fluturimin në një mënyrë që zvogëlon efektin te palët e treta në ajër ose në tokë.
 - 6) me përjashtim të rasteve kur është një UA me krah të fiksuar, të ketë treguesin e nivelit të fuqisë së tingullit të ponderuar A të garantuar të përcaktuar sipas pjesës 13 të vendosur në UA dhe/ose paketimin e tij sipas pjesës 14;
 - 7) të furnizohet ekskluzivisht nga energjia elektrike;
 - 8) të ketë një numër serial unik fizik që përputhet me *Numrat serialë të sistemeve ajrore të vogla pa pilot të standardit ANSI/CTA-2063-A-2019, Small Unmanned Aerial Systems Serial Numbers, 2019;*
 - 9) përveç rastit kur është i lidhur, të ketë një identifikim direkt nga distanca që:
 - a) lejon ngarkimin e numrit të regjistrimit të operatorit UAS, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot dhe çdo numër shtesë dhënë nga sistemi i regjistrimit; sistemi do të bëjë kontrole të vazhdueshme, duke verifikuar integritetin e të gjithë zinxhirit dhënë operatorit të UAS-së në kohën e regjistrimit; në rast të papajtueshmërisë, UAS do të japë për operatorin një mesazh gabimi “error message”;
 - b) siguron, në kohë reale gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, transmetimin direkt periodik nga UA-ja, duke përdorur një protokoll transmetimi të hapur dhe të dokumentuar, të të dhënave vijuese, në një mënyrë që ato të mund të merren direkt nga pajisjet ekzistuese të lëvizshme brenda diapazonit të transmetimit;

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit dhënë nga shteti i regjistrimit gjatë procesit të regjistrimit, përveçse kur kontrolli i pajtueshmërisë, sipas germës “a” të kësaj pike nuk është kaluar me sukses.

ii. numrin unik fizik serial të UA-së, në përputhje me pikën 8;

iii. stampën e kohës dhe pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv. kursin e rrugës së matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësinë tokësore të UA-së; dhe

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë; nëse nuk është e mundur pikën e ngritjes;

vi. një sinjalizim mbi statusin e emergjencës së UAS-së.

c) ul aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në largësi.

10) të pajiset me një funksion gjeondërgjegjësimi, që siguron:

a) një ndërfaqe për të ngarkuar dhe të përditësuar të dhëna që përmbajnë informacione mbi kufizimet e hapësirës ajrore të lidhura me pozicionin e UA-së dhe lartësinë e imponuar nga zonat gjeografike, siç përcaktohet në Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat e Operimit të Avionëve pa pilot, e cila siguron që procesi i ngarkimit ose përditësimi i këtyre të dhënave nuk e degradon integritetin dhe vlefshmërinë e tij;

b) një alarm paralajmërues për pilotin në distancë, kur konstatohet një shkelje e mundshme e kufizimeve të hapësirës ajrore; dhe

c) informacion për pilotin në distancë mbi statusin e UA-së, si dhe një alarm paralajmërues, kur pozicionimi ose lundrimi i tij nuk mund të sigurojë funksionimin e duhur të sistemit gjeondërgjegjësimi;

11) nëse UA-ja ka një funksion që kufizon hyrjen e tij në zona të caktuara të hapësirës apo të vëllimeve ajrore, ky funksion duhet të operojë në atë mënyrë që të bashkëveprojë pa probleme me sistemin e kontrollit të fluturimit të UA-së, pa ndikuar negativisht në sigurinë e fluturimit; përveç kësaj, informacioni i qartë do t'i sigurohet pilotit në distancë, kur ky funksion parandalon UA-në të hyjë në këto zona ose vëllime të hapësirës ajrore;

12) përveç nëse është lidhur, të pajiset me një lidhje të dhënash të mbrojtura nga hyrja e paautorizuar në komandat dhe funksionet e kontrollit;

13) t'i sigurojë pilotit në distancë një paralajmërim të qartë, kur bateria e UA-së ose stacioni i saj i kontrollit arrin një nivel të ulët, të tillë që piloti në distancë të ketë kohën e mjaftueshme për të ulur në mënyrë të sigurt UA;

14) të pajiset:

a) me drita me qëllim të kontrollueshmërisë së UA-së; dhe

b) të paktën një dritë jeshile pulsuese, me qëllim të dallimit/dukshmërisë së UA-së gjatë natës, që t'i mundësojë një personi në tokë, të dallojë UA-në nga një avion i drejtuar me pilot;

15) të hidhet në treg me manualin e një përdoruesi, i cili siguron:

a) karakteristikat e UA përfshirë, por jo vetëm të kufizuara, në:

- klasën e UA-së;

- peshën UA (me një përshkrim të konfigurimit të referencës) dhe peshën maksimale të ngritjes (MTOM);

- karakteristikat e përgjithshme të ngarkesave të lejuara për sa u përket dimensioneve të peshës, ndërfaqeve me UA-në dhe kufizimeve të tjera të mundshme;

- pajisjet dhe programet softuer për të kontrolluar UA-në nga distanca;

- procedurat për të ngarkuar në sistemin e identifikimit në distancë, numrin e regjistrimit të operatorit të UAS-së;

- referencën e protokollit të transmetimit të përdorur për emetimin direkt të identifikimit në distancë;

- nivelin e fuqisë së tingullit;

- dhe një përshkrim të sjelljes së UA-së, në rast të humbjes së lidhjes së komandës dhe kontrollit dhe mënyrës së rifitimit;

b) udhëzime të qarta operative;

c) procedurën për të ngarkuar kufizimet e hapësirës ajrore në funksionin e gjeondërgjegjësimi;

- d) udhëzimet e mirëmbajtjes;
- e) procedurat e zgjidhjes së problemeve
- f) kufizimet operacionale (përfshirë, por jo të kufizuara në kushtet meteorologjike dhe operimet ditore/të natës); dhe

g) përshkrimin e duhur të të gjitha rreziqeve që lidhen me operimet UAS;

16) të përfshijë një njoftim informacioni të publikuar nga Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (EASA) apo AAC-ja, sipas rastit që parashikon kufizime dhe detyrime të zbatueshme, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot.

17) nëse është i pajisur me një sistem rrjeti të identifikimit në distancë, do të:

a) lejojë, në kohë reale gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, transmetimin direkt periodik nga UA-ja, duke përdorur një protokoll transmetimi të hapur dhe të dokumentuar, të të dhënave vijuese, në një mënyrë që ato të mund të merren nëpërmjet një rrjeti:

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit dhënë nga shteti i regjistrimit gjatë procesit të regjistrimit, përveçse kur kontrolli i pajtueshmërisë, sipas gërmës “a”, të pikës 9 nuk është kaluar me sukses;

ii. numrin unik fizik serial të UA-së në përputhje me pikën 8;

iii. vulën e kohës (*time-stamp*), pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv. kursin e rrugës së matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësia tokësore e UA-së; dhe

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë ose nëse nuk është i disponueshëm, të pikës së ngritjes;


vi. një orientim për statusin e emergjencës së UAS-së;

b) ulë aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në largësi.

PJESA 5

KËRKESAT PËR NJË SISTEM AVIONI PA PILOT I KLASIT C4

Një UAS e klasit C4 ka etiketën e identifikimit klasor në UA në mënyrë të dukshme si vijon:



Një UAS e klasit C4 do të jetë në përputhje, me

1) të ketë një MTOM më të vogël se 25 kg, për nga një pilot në distancë, duke ndjekur udhëzimet e prodhuesit, si të operimit, duke përfshirë dështimin/mosfunksionimin të më shumë sistemeve; e parashikuara përshtatshme,

2) të jetë i kontrollueshëm në mënyrë të sigurt gjatë fluturimit, pa ndihmë automatik, përveç ndihmës për stabilizimin e fluturimit, pa efekt të drejtpërdrejtë në trajektoren dhe asistencën e lidhjes së humbur, me kusht që një pozicion fiks i paracaktuar i kontrollit të fluturimit, në rast të lidhjeve të humbura të jetë në dispozicion;

3) të mos jetë në gjendje të operojë me modalitet të kontrollit të drejtpërdrejtë në trajektoren dhe asistencën e lidhjes së humbur, me kusht që një pozicion fiks i paracaktuar i kontrollit të fluturimit, në rast të lidhjeve të humbura të jetë në dispozicion;

4) të hidhet në treg me manualin e një përdoruesi, i cili siguron:

a) karakteristikat e UA-së përfshirë, por jo vetëm të kufizuara në:

- klasin e UA-së;
- peshën e UA-së (me një përshkrim të konfigurimit të referencës) dhe peshën maksimale të ngritjes (MTOM);

- karakteristikat e përgjithshme të ngarkesave të lejuara, për sa u përket dimensioneve të masës, ndërfaqeve me UA-në dhe kufizimeve të tjera të mundshme;

- pajisjet dhe programet softuer për të kontrolluar UA-në nga distanca;

- dhe një përshkrim të sjelljes së UA-së, në rast të humbjes së lidhjes së të dhënave;

- b) udhëzime të qarta operative;
 - c) udhëzimet e mirëmbajtjes;
 - d) procedurat e zgjidhjes së problemeve;
 - e) kufizimet operationale (përfshirë, por jo të kufizuara në kushtet meteorologjike dhe operimet ditore/të natës); dhe
 - f) përshkrimin e duhur të të gjitha rreziqeve që lidhen me operimet UAS;
- 5) të përfshijë një njoftim informacioni të publikuar nga Agjencia e Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian (EASA) apo AAC-së, sipas rastit që parashikon kufizime dhe detyrime të zbatueshme, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat për Operimin e Avionëve pa Pilot.

PJESA 6 KËRKESAT PËR ELEMENT SHITESË TË DREJTPËRDREJTË TË IDENTIFIKIMIT NË DISTANCË

Një element shtesë i drejtpërdrejtë i identifikimit në distancë duhet të përputhet, me sa vijon:

1) lejon ngarkimin e numrit të regjistrimit të operatorit UAS, në përputhje me Rregulloren mbi Rregullat dhe Procedurat e Operimit të Avionëve pa Pilot dhe çdo numër shtesë dhënë nga sistemi i regjistrimit; sistemi do të bëjë kontrole të vazhdueshme, duke verifikuar integritetin e të gjithë zinxhirit dhënë operatorit të UAS-së në kohën e regjistrimit; në rast të papajtueshmërisë, UAS do të japë për operatorin një mesazh gabimi “*error message*”;

2) ka një numër serial fizik në përputhje me Numrat Serialë të Sistemeve Ajrore të Vogla pa Pilot të standardit ANSI/CTA-2063-A-2019, *Small Unmanned Aerial Systems Serial Numbers*, 2019, të bashkangjitur në elementin shtesë dhe paketimin e tij ose manualin e përdoruesit të tij në një mënyrë të lexueshme;

3) siguron, në kohë reale gjatë gjithë kohëzgjatjes së fluturimit, transmetimin direkt periodik nga UA-ja, duke përdorur një protokoll transmetimi të hapur dhe të dokumentuar, të të dhënave vijuese, në një mënyrë që ato të mund të merren direkt nga pajisjet ekzistuese të lëvizshme brenda diapazonit të transmetimit:

i. numrin e regjistrimit të operatorit UAS dhe kodin e verifikimit dhënë nga shteti i regjistrimit gjatë procesit të regjistrimit, përveçse kur kontrolli i pajtueshmërisë, sipas pikës 1 nuk është kaluar me sukses;

ii. numrin unik fizik të serisë së shtesës në përputhje me pikën 2;

iii. pozicionin gjeografik të UA-së dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes;

iv. kursin e rrugës së matur në drejtim të akrepave të orës nga veriu i vërtetë dhe shpejtësinë tokësore të UA-së; dhe

v. pozicionin gjeografik të pilotit në distancë ose nëse nuk është i disponueshëm, të pikës së ngritjes;

4) ulë aftësinë e cenimit të funksionalitetit të sistemit të identifikimit të drejtpërdrejtë në largësi;

5) është hedhur në treg me një manual të përdoruesit që jep referencën e protokollit të transmetimit të përdorur për emetimin direkt të identifikimit në distancë dhe udhëzimin, për:

a) instalimin e modulit në UA;

b) ngarkimin e numrit të regjistrimit të operatorit UAS.

PJESA 7 MODULI A I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT – KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

1. **Kontrolli i brendshëm i prodhimit** është procedura e vlerësimit të konformitetit, me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të kësaj pjese, siguron dhe

deklaron në përgjegjësinë e tij ekskluzive që produktet në fjalë plotësojnë kërkesat e përcaktuara në pjesët 1, 5, 6, 16 ose 17 që zbatohen për to.

2. Dokumentacioni teknik

Prodhuesi duhet të hartojë dokumentacionin teknik në përputhje me këtë rregullore.

3. Prodhimi

Prodhuesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojë përputhjen e produktit të prodhuar me dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 2 të kësaj pjese dhe me kërkesat e përcaktuara në pjesët 1, 5, 6, 16 ose 17 cilat zbatohen për to.

4. Markimi i CE-së dhe deklarata e konformitetit të BE-së

1) Në përputhje me legjislacionin përkatës dhe me këtë rregullore, prodhuesi duhet të vendosë shenjën CE dhe, kur është e përshtatshme, etiketën e identifikimit të klasës UA, për secilin produkt individual, që plotëson kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në pjesët 1, 5, 6, 16 ose 17 zbatohen për to.

2) Prodhuesi duhet të hartojë një deklaratë konformiteti në formë të shkruar për secilin model të produktit dhe duhet ta mbajë atë së bashku me dokumentacionin teknik në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi produkti të dalë në treg. Deklarata e konformitetit duhet të identifikojë qartë produktin për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

5. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesve të përcaktuara në pikën 4 mund të përmbushen nga një përfaqësues i autorizuar, në emër të tyre dhe nën përgjegjësinë e tyre, me kusht që ato të specifikohen në autorizim.

PJESA 8

MODULET B DHE C TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT – EKZAMINIMI I TIPIT EU DHE KONFORMITETI PËR TIPIN BAZUAR NË KONTROLLIN E BRENDSHËM TË PRODHIMIT

Kur bëhet referenca në këtë pjesë, procedura e vlerësimit të konformitetit do të ndjekë modulet B (ekzaminimi i tipit – BE) dhe C (konformiteti për tipin bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit) të kësaj pjesë.

Moduli B

Ekzaminimi i tipit – EU

1. Ekzaminimi i tipit EU është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit në të cilën një organ i notifikuar ekzaminon projektimin teknik të produktit dhe verifikon dhe vërteton se projektimi teknik i produktit plotëson kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në pjesët nga 1 deri në 6, 16 dhe 17.

2. Ekzaminimi i tipit EU do të bëhet me një vlerësim të përshtatshme të projektit teknik të produktit përmes ekzaminimit të dokumentacionit teknik dhe provave mbështetëse të përmendura në pikën 3, plus ekzaminimin e mostrave, përfaqësuese të prodhimit të parashikuar, të një ose më shumë pjesëve të rëndësishme të produktit (kombinimi i tipit të prodhimit dhe llojit/tipit të projektimit).

3. Prodhuesi duhet të paraqesë një kërkesë për ekzaminim të tipit – EU me një organ të vetëm të njoftuar për zgjedhjen e tij.

Kërkesa duhet të përfshijë:

1) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e tij;

2) një deklaratë me shkrim, që e njëjta kërkesë nuk është paraqitur te ndonjë organ tjetër i njoftuar;

3) dokumentacionin teknik; dokumentacioni teknik do të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje dhe do të përfshijë një

analizë dhe vlerësim të përshtatshëm të rrezikut/rreziqeve. Dokumentacioni teknik do të përmbajë, kur është e nevojshme, elementet e përcaktuara në këtë rregullore;

4) përfaqësuesin e mostrave të prodhimit të parashikuar. Organi i notifikuar mund të kërkojë ekzemplarë të tjerë, nëse është e nevojshme për kryerjen e programit të testimit;

5) provat mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektimit teknik. Kjo dëshmi mbështetëse do të përmendë çdo dokument që është përdorur, veçanërisht kur standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose specifikimet teknike nuk janë aplikuar ose nuk janë aplikuar në tërësi; provat mbështetëse përfshijnë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera, në përputhje me specifikimet e tjera teknike përkatëse nga laboratorit përkatës i prodhuesit ose nga një laborator tjetër testimi për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

4. Organi i notifikuar duhet:

Për produktin:

1) të ekzaminojë dokumentacionin teknik dhe provat mbështetëse për të vlerësuar përshtatshmërinë e projektimit teknik të produktit.

Për mostrën/at:

2) të verifikojë që mostra/t është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe të identifikojë elementet që janë projektuar, në përputhje me dispozitat e zbatueshme të standardeve përkatëse të harmonizuara dhe/ose specifikimet teknike, si dhe elementet që janë projektuar pa zbatuar dispozitat përkatëse të këtyre standardeve;

3) të kryejë ekzaminime dhe teste të përshtatshme ose të bëjë të mundur që të procedohet me kryerjen e tyre, për të verifikuar, në rast se prodhuesi, ka zgjedhur të zbatojë zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose specifikimet teknike, nëse këto janë zbatuar në mënyrë korrekte;

4) të kryejë ekzaminime dhe teste të përshtatshme ose të bëjë që të procedohet me kryerjen e tyre, për të për të verifikuar, në rastet kur nuk janë zbatuar zgjidhjet në standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose specifikimet teknike, nëse zgjidhjet e adaptuara nga prodhuesi plotësojnë kërkesat përkatëse thelbësore të instrumentit legjislativ;

5) të bjerë dakord me prodhuesin për një vend ku do të kryhen ekzaminimet dhe provat/testimet.

5. Organi i notifikuar do të hartojë një raport vlerësimi që regjistron aktivitetet e ndërmarra në përputhje me pikën 4 dhe rezultatet e tyre. Pa cenuar detyrimet e tij, siç parashikohet në pikën 8, organi i notifikuar do të lëshojë përmbajtjen e këtij raporti, plotësisht ose pjesërisht, vetëm me marrëveshjen e prodhuesit.

6. Nëse tipi/lloji i plotëson kërkesat e kësaj rregulloreje, organi i notifikuar do t'i lëshojë prodhuesit një certifikatë ekzaminimi të tipit – EU. Kjo certifikatë duhet të përmbajë emrin dhe adresën e prodhuesit, përfundimet e ekzaminimit, aspektet përkatëse të kërkesave të mbuluara nga ekzaminimi, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e tij, si dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të miratuar. Certifikatës mund t'i bashkëngjiten një ose më shumë shtojca.

Certifikata EU dhe shtojcat e saj duhet të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës për të lejuar vlerësimin e konformitetit të produkteve të prodhuara me tipin e ekzaminuar dhe për të lejuar kontrollin e shërbimit.

Kur tipi nuk i plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje, organi i njoftuar do të refuzojë të lëshojë një certifikatë ekzaminimi të tipit shqiptare ose të BE-së dhe do të informojë përkatësisht aplikuesin, duke dhënë arsye të hollësishme për refuzimin e tij.

7. Organi i notifikuar do të mbajë veten të informuar për të njohur çdo ndryshim në gjendjen e përgjithshme e më të fundit të produktit, që tregon se tipi i miratuar nuk mund të përputhet më me kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje dhe do të përcaktojë nëse këto ndryshime kërkojnë hetim të mëtejshëm. Nëse është kështu, organi i notifikuar duhet të informojë prodhuesit përkatësisht.

Prodhuesi do të informojë organin e notifikuar që mban dokumentacionin teknik, në lidhje me certifikatën e ekzaminimit të tipit EU, për të gjitha ndryshimet në tipin e miratuar që mund të ndikojnë në konformitetin e produktit me kërkesat thelbësore të kësaj rregulloreje ose kushtet për

vlefshmërinë e certifikatës. Ndryshime të tilla kërkojnë miratim shtesë dhe i bashkëngjiten certifikatës origjinale të miratimit të tipit EU.

8. Secili organ i notifikuar do të informojë autoritetin e tij notifikues, në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit BE dhe/ose çdo shtesë që ai ka lëshuar ose tërhequr, dhe do t'i vërë në dispozicion periodikisht ose me kërkesë, autoritetit njoftues listën e certifikatave dhe/ose ndonjë shtesë të refuzuar, pezulluar ose ndryshe të kufizuar.

Çdo organ i notifikuar do të informojë organet e tjera të notifikuara, në lidhje me certifikatat e ekzaminimit të tipit BE dhe/ose çdo shtesë ose që ai ka refuzuar, tërhequr, pezulluar ose kufizuar dhe, sipas kërkesës, në lidhje me certifikatat dhe/ose shtesat që ai ka lëshuar.

Komisioni, Shtetet Anëtare dhe organet e tjera të notifikuara mund, me kërkesë, të marrin një kopje të certifikatave të ekzaminimit të tipit – BE dhe/ose të shtesave të tyre. Me një kërkesë të arsyetuar Komisioni dhe Shtetet Anëtare mund të marrin një kopje të dokumentacionit teknik dhe rezultatet e ekzaminimeve të kryera nga organi i notifikuar.

Organi i notifikuar mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit BE, anekset dhe shtesat e tij, si dhe dosjen teknike/dokumentacionin teknik, duke përfshirë dokumentacionin e paraqitur nga prodhuesi për 10 vjet, pasi të jetë vlerësuar produkti ose derisa të skadojë vlefshmëria e certifikatës.

9. Prodhuesi mban një kopje të certifikatës së ekzaminimit të tipit – BE , shtojcat dhe shtesat e saj, së bashku me dokumentacionin teknik, në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet pasi produkti të dalë në treg.

10. Përfaqësuesi i autorizuar i prodhuesit mund të paraqesë kërkesën e përmendur në pikën 3 dhe të përmbushë detyrimet e përcaktuara në pikat 7 dhe 9, me kusht që ato të specifikohen në autorizim.

Moduli C

Konformiteti me tipin, bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit

1. Konformiteti i tipit bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit është pjesa e një procedure të vlerësimit të konformitetit, me të cilën prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3, dhe siguron dhe deklaron që produktet në fjalë janë në përputhje me tipin e përshkruar në një certifikatë ekzaminimi të tipit – BE dhe plotësojnë kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje.

2. Prodhimi

Prodhuesi do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi i prodhimit dhe monitorimi i tij të sigurojnë konformitetin e produktit të prodhuar me tipin e miratuar të përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit – BE dhe me kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në pjesët nga 1 deri në 6, 16 dhe 17.

3. Markimi CE dhe deklarata e konformitetit EU

1) Prodhuesi do të vendosë markimin CE dhe, kur është e nevojshme, etiketën e identifikimit të klasit UA, në përputhje me këtë rregullore, mbi secilin produkt që është në përputhje me tipin e përshkruar në certifikatën e ekzaminimit të tipit – EU dhe përmbush kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në pjesët nga 1 deri në 6, 16 dhe 17.

2) Prodhuesi do të hartojë një deklaratë të shkruar EU për konformitetin për secilin tip të produktit dhe do ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi produkti të dalë në treg. Deklarata e konformitetit e EU-së duhet të përcaktojë qartë tipin e produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit EU do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me kërkesë.

4. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikën 3 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tyre i autorizuar, për llogari të tyre dhe nën përgjegjësinë e tyre, me kusht që kjo të specifikohet në autorizim.

I BAZUAR NË SIGURIMIN E PLOTË TË CILËSISË

1. Konformiteti i bazuar në sigurinë e plotë të cilësisë është procedura e vlerësimit të konformitetit, mbi bazën e së cilës prodhuesi përmbush detyrimet e përcaktuara në pikat 2 dhe 5, dhe siguron dhe deklaron në përgjegjësinë e tij ekskluzive që produkti në fjalë plotëson kërkesat e zbatueshme të përcaktuara në pjesët nga 1 deri 6, 16 dhe 17.

2. Prodhueshmëria

Prodhuesi do të përdorë një sistem cilësie të miratuar për projektimin, prodhimin, inspektimin përfundimtar dhe testimin e produktit në fjalë, siç specifikohet në pikën 3 dhe do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes siç përcaktohet në pikën 4.

3. Sistemi i cilësisë

1) Prodhuesi duhet të paraqesë një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë pranë organit të notifikuar të zgjedhur prej tij, për produktin në fjalë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit dhe, nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i autorizuar, emrin dhe adresën e këtij të fundit, gjithashtu;

b) dokumentacionin teknik për secilin tip produkti që synohet të prodhohet;

c) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë;

d) një deklaratë me shkrim që thotë se e njëjta kërkesë nuk është paraqitur pranë ndonjë organi tjetër të notifikuar.

2) Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e produktit me kërkesat e kësaj rregulloreje.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e miratuara nga prodhuesi do të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë do të lejojë një interpretim të qëndrueshëm të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave të cilësisë.

Dokumentacioni, në veçanti, duhet të përmbajë një përshkrim të përshtatshëm, të:

a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjëseve dhe kompetencave të menaxhimit, në lidhje me projektimin dhe cilësinë e produktit;

b) specifikimeve të projektimit teknik, përfshirë standardet, që do të zbatohen dhe, aty ku standardet përkatëse të harmonizuara nuk do të zbatohen plotësisht, mjeteve që do të përdoren për të siguruar përmbushjen e kërkesave të kësaj rregulloreje;

c) kontrollit të projektimit dhe teknikave të verifikimit të projektimit, proceseve dhe veprimeve sistematike që do të përdoren gjatë projektimit të produkteve, që i përkasin llojit të produktit të mbuluar;

d) teknikave, proceseve dhe veprimeve sistematike përkatëse të prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe garantimit të cilësisë që do të përdoren;

e) ekzaminimeve dhe provave që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe shpeshësisë me të cilën do të kryhen;

f) regjistrimeve të cilësisë, të tilla si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testeve, të dhënat e kalibrimit, raportet në lidhje me kualifikimet ose miratimet e personelit të interesuar etj.;

g) mjeteve të monitorimit të arritjes së projektimit të kërkuar dhe cilësisë së produktit, si dhe funksionimit efektiv të sistemit të cilësisë.

3) Organi i notifikuar vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse i plotëson kërkesat e përmendura në pikën 3(2).

Ai do të supozojë konformitetin me këto kërkesa, në lidhje me elementet e sistemit të cilësisë, që përputhen me specifikimet përkatëse të standardit përkatës të harmonizuar.

Përveç përvojës në sistemet e menaxhimit të cilësisë, ekipi i auditimit duhet të ketë së paku një anëtar me përvojë si vlerësues në fushën përkatëse të produktit dhe teknologjinë e produktit në fjalë, si dhe njohuri për kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje. Auditimi duhet të përfshijë një vizitë vlerësuese në ambientet e prodhuesit. Ekipi i auditimit do të rishikojë dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3(1)(b) për të verifikuar aftësinë e prodhuesit për të identifikuar kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje dhe për të kryer ekzaminimet e nevojshme, me qëllim që të sigurojë përputhjen e produktit me këto kërkesa.

Prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të njoftohet për vendimin.

Njoftimi duhet të përmbajë përfundimet e auditimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4) Prodhuesi duhet të marrë përsipër që të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë, siç është miratuar, dhe ta ruajë atë në mënyrë që të mbetet i duhur dhe efikas.

Prodhuesi duhet ta mbajë në dijeni organin e notifikuar që ka miratuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të synuar në sistemin e cilësisë.

5) Organi i notifikuar duhet të vlerësojë çdo ndryshim të propozuar dhe të vendosë nëse sistemi i cilësisë i modifikuar do të vazhdojë të përmbushë kërkesat e përmendura në pikën 3(2) ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Organi i notifikuar duhet të njoftojë prodhuesin për vendimin e tij. Njoftimi duhet të përmbajë përfundimet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të notifikuar

1) Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurohet që prodhuesi i përmbush rregullisht detyrimet që rrjedhin nga sistemi i miratuar i cilësisë.

2) Prodhuesi, për qëllime vlerësimi, duhet t'i lejojë organit të notifikuar qasjen në vendet e projektimit, prodhimit, inspektimit, testimit dhe ruajtjes, dhe duhet t'i sigurojë atij të gjitha informacionet e nevojshme, veçanërisht:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) regjistrimet e cilësisë të parashikuara nga pjesa e projektimit të sistemit të cilësisë, siç janë rezultatet e analizave, llogaritjeve, testeve etj.;

c) regjistrimet e cilësisë të parashikuara nga pjesa prodhuese e sistemit të cilësisë, siç janë raportet e inspektimit dhe të dhënat e provës, të dhënat e kalibrimit, raportet në lidhje me kualifikimet e personelit etj.

3) Organi i notifikuar duhet të kryejë kontrole periodike për t'u siguruar që prodhuesi mban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i siguron prodhuesit një raport auditimi.

4) Për më tepër, organi i notifikuar mund të bëjë vizita të papritura te prodhuesi. Gjatë këtyre vizitave, organi i notifikuar mundet, nëse është e nevojshme, të kryejë teste UA ose UAS, ose të bëjë të mundur që të procedohet me kryerjen e tyre, për të kontrolluar funksionimin e duhur të sistemit të cilësisë. Ai duhet t'i sigurojë prodhuesit një raport të vizitës dhe, nëse janë bërë teste, një raport të testimit.

5. Markimi CE dhe deklarata e EU-së e konformitetit

1) Prodhuesi duhet të vendosë markën CE dhe, kur është e përshtatshme, etiketën e identifikimit të klasës UAS, në përputhje me këtë rregullore, dhe nën përgjegjësinë e organit të notifikuar të përmendur në pikën 3(1) të kësaj pjese, numrin e identifikimit të këtij të fundit për secilin produkt individual, që plotëson kërkesat e zbatueshme të kësaj rregulloreje.

2) Prodhuesi duhet të hartojë një deklaratë të shkruar EU për konformitetin, për secilin tip produkti dhe duhet ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve kombëtare për 10 vjet, pasi produkti të dalë në treg. Deklarata e konformitetit EU do të identifikojë tipin e produktit për të cilin është hartuar.

Një kopje e deklaratës së konformitetit EU do të vihet në dispozicion të autoriteteve përkatëse me anë të një kërkesë.

6. Prodhuesi, për një periudhë që përfundon 10 vjet, pasi produkti të dalë në treg, duhet të mbajë në dispozicion për autoritetet kombëtare:

1) dokumentacionin teknik të përmendur në pikën 3(1);

2) dokumentacionin në lidhje me sistemin e cilësisë të përmendur në pikën 3(1);

3) ndryshimin e përmendur në pikën 3(5), të miratuar;

4) vendimet dhe raportet e organit të njoftuar të përmendur në pikat 3(5), 4(3) dhe 4(4).

7. Çdo organ i notifikuar do të informojë autoritetin e tij notifikues për miratimet e sistemit të cilësisë, të lëshuara ose të tërhequra, dhe, në mënyrë periodike ose me kërkesë, do t'i vërë në dispozicion autoritetit njoftues listën e miratimeve të sistemit të cilësisë që ai ka refuzuar, pezulluar ose kufizuar.

Çdo organ i notifikuar do të informojë organet e tjera të notifikuara për miratimet e sistemit të cilësisë, të cilat ai ka refuzuar, pezulluar ose tërhequr dhe, sipas kërkesës, për miratimet e sistemit të cilësisë që ai ka lëshuar.

8. Përfaqësuesi i autorizuar

Detyrimet e prodhuesit të përcaktuara në pikat 3(1), 3(5), 5 dhe 6 mund të përmbushen nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij, me kusht që kjo të specifikohet në autorizim.

PJESA 10 PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIK

Prodhuesi duhet të përcaktojë dokumentacionin teknik. Dokumentacioni duhet të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat në fuqi.

Dokumentacioni teknik, kur është e mundur, duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

1. Një përshkrim të plotë të produktit, duke përfshirë:
 - a) fotografi ose ilustrime që tregojnë tiparet e tij të jashtme, shenjat dhe paraqitjen e brendshme;
 - b) versionet e çdo programi kompjuterik të përfshirë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga kjo rregullore;
 - c) manualin e përdoruesit dhe udhëzimet e instalimit.
2. Projekti konceptual dhe vizatimet prodhuese dhe skemat e komponentëve, qarqeve dhe elementeve të tjera të ngjashme përkatëse.
3. Përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për t'i kuptuar këto vizatime dhe skema, si dhe funksionimin e produktit.
4. Një listë të standardeve të harmonizuara shqiptare, të zbatuara plotësisht ose pjesërisht, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, dhe, kur këto standarde të harmonizuara nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve të miratuara për plotësimin e kërkesave thelbësore të përcaktuara në nenin 4, duke përfshirë një listë të specifikimeve të tjera teknike përkatëse të aplikuara. Në rast të standardeve të harmonizuara pjesërisht të zbatuara, dokumentacioni teknik përcakton pjesët që janë zbatuar.
5. Kopje të deklaratës EU të konformitetit.
6. Nëse është zbatuar moduli i vlerësimit të konformitetit në pjesën 8, kopjen e certifikatës së ekzaminimit të tipit shqiptare dhe anekset e saj, të dorëzuara nga organi i notifikuar i përfshirë.
7. Rezultatet e llogaritjeve të bëra në projektim, ekzaminimet e kryera dhe elementet e tjera të ngjashme lidhur me to.
8. Raportet e testeve.
9. Kopjet e dokumenteve, që prodhuesi i ka paraqitur organit të notifikuar nëse është i përfshirë;
10. Provat mbështetëse për përshtatshmërinë e zgjidhjes së projektit teknik. Këto dëshmi mbështetëse do të përmendin çdo dokument që është përdorur, veçanërisht kur standardet përkatëse të harmonizuara dhe/ose specifikimet teknike nuk janë zbatuar plotësisht. Provat mbështetëse duhet të përfshijnë, kur është e nevojshme, rezultatet e testeve të kryera nga laboratorit përkatës i prodhuesit ose nga një laborator tjetër testimi për llogari të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.
11. Adresat e vendeve të prodhimit dhe magazinimit.

PJESA 11 DEKLARATA EU E KONFORMITETIT

1. Produkti (tipi, seria dhe numri serial).
2. Emri dhe adresa e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

3. Kjo deklaratë e konformitetit lëshohet nën përgjegjësinë ekskluzive të vetë prodhuesit [në rast të një seti aksesorësh, prodhuesi i aksesorëve mund të theksojë se kjo certifikatë është mbi certifikatën e UAS-së, për të cilin seti garanton konvertimin].

4. Objekti i deklaratës [identifikimi i produktit që lejon gjurmueshmërinë; mund të përfshijë një imazh me ngjyra të rezolucionit të mjaftueshëm, aty ku është e nevojshme për identifikimin e produkteve, në rast të një seti aksesorësh, identifikoni UAS për të cilin seti garanton konvertimin].

5. Objekti i deklaratës së përshkruar më lart është i klasës ... [përfshini për UAS-në numrin e klasës, siç përcaktohet në pjesët nga 1 deri 5, 16 dhe 17 të këtij aneksi. Në rast të një seti aksesorësh, identifikoni klasën në të cilin UAS konvertohet].

6. Niveli i garantuar i fuqisë së tingullit për këtë pajisje UAS është ... dB (A) [vetëm për klasat me krah të pafiksuar UAS nga 1 deri 3]

7. Objekti i deklaratës së përshkruar më sipër është në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar ose të BE-së:

- [përfshini referencën e kësaj rregulloreje dhe aneksin përkatës për klasën e produktit];
- ose një legjislacion tjetër të BE-së, aty ku zbatohet.

8. Referencat në standardet përkatëse të harmonizuara të përdorura ose referencat në specifikimet e tjera teknike, në lidhje me të cilat deklarohet konformiteti. Referencat duhet të shënohen me numrin dhe versionin e tyre të identifikimit dhe, kur është e përshtatshme, datën e lëshimit.

9. Kur është e aplikueshme, organi i njoftuar ... [emri, numri]... ka kryer ... [përshkrimi i ndërhyrjes] ... dhe ka lëshuar certifikatën e ekzaminimit të tipit të BE-së.

10. Kur është e aplikueshme, një përshkrim i aksesorëve dhe komponentëve, përfshirë softuerin, të cilat lejojnë që avioni pa pilot ose sistemi i avionëve pa pilot të funksionojnë, siç synohet dhe mbulohet nga deklarata e konformitetit e BE-së.

11. Informacione shtesë:

Nënshkruar për llogari dhe në emër të: ...

[vendi dhe data e lëshimit]:

[emri, funksioni] [nënshkrimi]:

PJESA 12

DEKLARATË E THJESHTUAR EU E KONFORMITETIT

Deklarata e thjeshtuar e konformitetit e BE-së e përmendur në nenin 13(3) do të jepet, si më poshtë:

- [Emri i prodhuesit] me këtë deklaron që UAS [identifikimi i UAS: lloji ose numri serial] është i klasit ... [përfshini numrin e klasës së produktit siç përcaktohet në pjesët nga 1 deri 5 dhe 16 dhe 17 të këtij aneksi. Në rast të një seti aksesorësh, identifikoni klasën në të cilin UAS konvertohet] dhe ka një nivel të fuqisë së tingullit të garantuar prej ... dB (A) [vetëm për klasat me krah të pafiksuar UAS nga 1 deri 3, 5 dhe 6].

- dhe në përputhje me rregulloret ... [renditni të gjitha rregulloret me të cilat produkti përputhet].

- Deklarata e plotë e konformitetit e BE-së është e aksesueshme në faqen e internetit në vijim: [adresa e internetit]

PJESA 13

KODI I PROVËS SË ZHURMËS

Kjo pjesë përcakton metodat e matjes së zhurmës në ajër që do të përdoret për përcaktimin e niveleve të fuqisë së tingullit me ponderim A të klasave 1, 2, 3, 5 dhe 6 të UA-së.

Ajo përcakton standardin themelor të emetimit të zhurmës dhe kodin e detajuar të provës për matjen e nivelit të presionit të tingullit mbi një sipërfaqe matëse, që mbështjell burimin dhe për llogaritjen e nivelit të fuqisë së tingullit të prodhuar nga burimi.

1. STANDARDI BAZË I EMETIMIT TË ZHURMËS

Për përcaktimin e nivelit të fuqisë së tingullit me ponderim A të L_{WA} të UA, standardet themelore të emetimit të zhurmës “SSH EN ISO 3744 – Akustika – Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zërit dhe i niveleve të energjisë së zërit të burimeve të zhurmës, duke përdorur presionin e zërit – Metodatat inxhinierike për një fushë në thelb të lirë mbi një plan reflektues” do të përdoren duke iu nënshtruar shtesave të mëposhtme:

2. KUSHTET E INSTALIMIT DHE MBROJTJES

Zona e provës

UA do të rrijë pezull mbi një plan/sipërfaqe reflektuese (akustikash të ashpër). UA do të vendoset në një distancë të mjaftueshme nga çdo mur ose tavan reflektues ose çdo objekt reflektues në mënyrë që kërkesat e dhëna në aneksin A të “SSH EN ISO 3744 – Akustika – Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zërit dhe niveleve të energjisë së zërit të burimeve të zhurmës, duke përdorur presionin e zërit – Metodatat inxhinierike për një fushë në thelb të lirë mbi një plan reflektues”, të përmbushen mbi sipërfaqen e matjes.

Sipërfaqja e matjes së tingullit dhe grupimi i mikrofonit

UA-ja do të mbyllet plotësisht në një sipërfaqe matëse hemisferë, sipas 7.2.3§ e “SSH EN ISO 3744 – Akustika – Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zërit dhe niveleve të energjisë së zërit të burimeve të zhurmës, duke përdorur presionin e zërit – Metodatat inxhinierike për një fushë në thelb të lirë mbi një plan reflektues”.

Numri dhe pozicioni i mikrofonave përcaktohet në aneksin F të “SSH EN ISO 3744 – Akustika – Përcaktimi i niveleve të fuqisë së zërit dhe i niveleve të energjisë së zërit të burimeve të zhurmës, duke përdorur presionin e zërit – Metodatat inxhinierike për një fushë në thelb të lirë mbi një plan reflektues”.

Sipërfaqja e matjes do të ketë origjinën e saj në pikën O, e shtrirë në plan tokësor direkt nën UA.

3. KUSHTET OPERATIVE GJATË TESTIT

Provat e zhurmës do të kryhen me rotorë të UA-së, që operojnë me një shpejtësi që korrespondon me fluturimin e UA nën MTOM.

Nëse UA hidhet/lançohet në treg me aksesore shtesë, që të instalohen/montohen tek ai, do të testohet me dhe pa këto aksesore në të gjitha konfigurimet e mundshme të UA-së.

4. LLOGARITJA E NIVELIT TË PRESIONIT TË TINGULLIT TË SIPËRFAQES, ME MESATARE KOHORE

Niveli i presionit të tingullit me mesatare kohore në sipërfaqen me ponderim A do të përcaktohet të paktën tri herë për secilin konfigurim të UA-së. Nëse të paktën dy nga vlerat e përcaktuara nuk ndryshojnë më shumë se 1 dB, matjet e mëtejshme nuk do të jenë të nevojshme; në të kundërt, matjet do të vazhdojnë derisa të merren dy vlera që ndryshojnë me jo më shumë se 1 dB. Niveli mesatar i presionit të tingullit të sipërfaqes me mesatare kohore, që do të përdoret për llogaritjen e nivelit të fuqisë së tingullit të një konfigurimi UA është mesatarja aritmetike e dy vlerave më të larta që nuk ndryshojnë më shumë se 1 dB.

5. INFORMACIONI QË DO TË RAPORTOHET

Raporti duhet të përmbajë të dhënat teknike të nevojshme për të identifikuar burimin që testohet, si dhe kodin e testit të zhurmës dhe të dhënat akustike.

Vlera e nivelit të fuqisë së tingullit me ponderim A për t'u raportuar është vlera më e lartë e konfigurimeve të ndryshme të UA-së të testuar të rrumbullakosura me numrin e plotë më të afërt (më pak se 0,5 përdoret numri më i ulët; më të madh se ose të barabartë me 0,5 përdoret numri më i lartë).

PJESA 14

TREGUESI I NIVELIT TË GARANTUAR TË FUQISË SË TINGULLIT

Treguesi i nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit duhet të përbëhet nga numri i vetëm i fuqisë së garantuar të tingullit në dB, shenja L_{WA} dhe një piktogram që merr formën e mëposhtme:



Nëse treguesi zvogëlohet sipas madhësisë së pajisjes, proporcionet e dhëna në vizatimin e mësipërm duhet të respektohen. Sidoqoftë, dimensionimi vertikal i treguesit duhet, nëse është e mundur, të mos jetë më pak se 20 mm.


PJESA 15
NIVELI MAKSIMAL I FUQISË SË TINGULLIT PËR KLASËN E UA (PËRFSHIRË PERIUDHAT E TRANZICIONIT)

Klasa UA	m MTOM në gram	Niveli maksimal i fuqisë së tingullit L_{WA} në dB		
		Duke filluar nga hyrja në fuqi	2 vite pas hyrjes në fuqi	4 vite pas hyrjes në fuqi
C1 dhe C2	$m < 900$	85	83	81
C2	$900 \leq m < 4\ 000$	$85 + 18,5 \lg \frac{m}{900}$	$83 + 18,5 \lg \frac{m}{900}$	$81 + 18,5 \lg \frac{m}{900}$

Ku “lg” është logaritmi me bazë 10.

PJESA 16
KËRKESAT PËR NJË SISTEM AVIONI PA PILOT TË KLASËS C5 DHE AKSESORË C5

Një UAS e klasës C5 mban etiketën e mëposhtme të identifikimit të klasës në UA:



Një UAS e klasës C5 duhet të përputhet me kërkesat e përcaktuara në pjesën 4, përveç atyre të përcaktuara në paragrafët 2) dhe 10) të pjesës 4.


Përveç kësaj, ai duhet të përputhet me kërkesat e mëposhtme:

- 1) të jetë një avion i ndryshëm nga një avion me krahë fiks, përveç se është i lidhur;
- 2) nëse është i pajisur me funksion gjeondërgjegjësimi, në përputhje me paragrafin 10) të pjesës 4;
- 3) gjatë fluturimit, t'i japë pilotit në distancë informacion të qartë dhe konciz mbi lartësinë e UA mbi sipërfaqe ose pikën e ngritje (*take-off*);
- 4) nëse nuk është i lidhur, të jetë i pajisur me një modalitet me shpejtësi të ulët të përzgjedhur nga piloti në distancë dhe që kufizon shpejtësinë në tokë në jo më shumë se 5 m/s;
- 5) nëse nuk është i lidhur, siguroni mjete për pilotin në distancë për të përfunduar fluturimin e UA, i cili do të:
 - a) të jetë i besueshëm, i parashikueshëm dhe i pavarur nga sistemi automatik i kontrollit dhe drejtimit të fluturimit; kjo vlen edhe për aktivizimin e këtij mjeti;

- b) të detyrojë zbritjen e UA-së dhe të parandalojë zhvendosjen e tij horizontale; dhe
- c) përfshijnë mjete për të reduktuar efektin e dinamikës së ndikimit të UA-së;
- 6) nëse nuk është i lidhur, t'i siguroj pilotit në distancë mjete për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e lidhjes së komandës dhe kontrollit dhe për të marrë një sinjalizim kur ka gjasa që lidhja do të humbasë ose degradohet deri në masën që të rrezikojë sjelljen e sigurt të operimit dhe një alarm tjetër kur lidhja humbet; dhe
- 7) përveç informacionit të treguar në pikën 15)(a) të pjesës 4, përfshini në udhëzimet e prodhuesit një përshkrim të mjeteve për të përfunduar fluturimin e kërkuar në pikën 5).
- 8) Një UAS e klasës C5 mund të përbëhet nga një UAS e klasës C3 e pajisur me një komplet aksesorësh që siguron konvertimin e UAS C3 në një UAS të klasës C5. Në këtë rast, etiketa e klasës C5 duhet të vendoset në të gjithë aksesorët.
- Një komplet aksesorësh mund të sigurojë vetëm konvertimin e një UAS-je të klasës C3, që përputhet me pikën 1) dhe siguron ndërfaqet e nevojshme me aksesorët.
- Kompleti i aksesorëve nuk duhet të përfshijë ndryshime në softuerin e UAS të klasës C3.
- Kompleti i aksesorëve do të projektohet dhe çdo aksesor duhet të identifikohet për të siguruar një instalim të plotë dhe korrekt nga një operator UAS në një UAS të klasës C3, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga prodhuesi i kompletit të aksesorëve.
- Kompleti i aksesorëve mund të vendoset në treg në mënyrë të pavarur nga UAS e klasës C3 për të cilin ata sigurojnë konvertimin. Në këtë rast, prodhuesi i kompletit të aksesorëve do të vendosë në treg një komplet të vetëm konvertimi që duhet:
- 1) të mos ndryshojë përputhshmërinë e UAS-së të klasës C3 me kërkesat e pjesës 4;
 - 2) të sigurojë përputhjen e UAS-së të pajisur me kompletin e aksesorëve me të gjitha kërkesat shtesë të përcaktuara në këtë pjesë, me përjashtim të pikës 3) më sipër; dhe
 - 3) të shoqërohet nga udhëzimet e prodhuesit, që ofrojnë:
 - i. listën e të gjitha UAS-ve të klasës C3, në të cilat mund të aplikohet kompleti; dhe
 - ii. udhëzime për mënyrën e instalimit dhe të përdorimit të kompletit të aksesorëve.

PJESA 17 KËRKESAT PËR NJË SISTEM AVIONI TË KLASËS C6

Një UAS e klasës C6 përmban etiketën e mëposhtme të identifikimit të klasës në UA:



Një UAS e klasës C6 duhet të përputhet me kërkesat e përcaktuara në pjesën 4, përveç atyre të përcaktuara në paragrafët 2), 7) dhe 10).

Përveç kësaj, ai duhet të përputhet me kërkesat e mëposhtme:

- 1) të ketë një shpejtësi maksimale në nivelin e fluturimit jo më shumë se 50 m/s;
- 2) nëse është e pajisur me funksionin e gjeondërgjegjes, të jetë konform me paragrafin 10 të pjesës 4;
- 3) gjatë fluturimit, t'i sigurojë pilotit në distancë informacion të qartë dhe konciz të pozicionit gjeografik të UA-së, shpejtësinë dhe lartësinë e tij mbi sipërfaqen ose pikën e ngritjes (*take-off*);
- 4) të mundësojë metoda parandalimi nga UA për të mos kaluar limitet vertikale dhe horizontale të volumit operacional të programuar;

5) të mundësojë metodologji për pilotin në distancë për të përfunduar fluturimin e UA, i cili do të:

a) jetë i qëndrueshëm, parashikueshëm, pavarur nga kontrolli i fluturimit automatik dhe sistemi udhëzues, pavarur nga mjetet e parandalimit të UA për shkeljen e limiteve horizontale dhe vertikale sipas kërkesës së pikës 4; kjo aplikohet dhe ndaj aktivizimit; dhe

b) fuqizojë uljen e UA-së dhe do të parandalojë zëvendësimin horizontal;

6) të mundësojë program për trajektoren e UA-së;

7) të mundësojë pilotin në distancë me mjetet e monitorimit të vazhdueshëm dhe kualitetit të komandës dhe kontrollit për të marrë alerte, kur është e mundur që linku të mos humbasë dhe të degradohet apo të kompromentojë operim të sigurt, si dhe një alert, kur linku humbet; dhe

8) përveç informacionit të pikës 15)(a) të pjesës 4, të përfshijë udhëzimet e prodhuesit:

a) përshkrim i mënyrës së përfundimit të fluturimit kërkuar sipas pikës 5;

b) përshkrim i metodës për të parandaluar UA-në nga kalimi i limiteve horizontale dhe vertikale të volumit dhe masës e volumit të kontigjencës, që nevojitet për të përshtatur dhe për të vlerësuar pozicionimin, gabimin, kohën e reagimit dhe kohën e manovrave korrigjuese; dhe

c) distancës që është më e mundur për udhëtim të UA-së pas aktivizimit për të përfunduar fluturimin e përcaktuar sipas pikës 5), që duhet të merret në parasysh nga operatori UAS, kur përcakton “*ground risk buffer*”.